



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2024 – Numri: 122

Tiranë – E enjte, 18 korrik 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 63/2024, datë 4.7.2024	Për rrëzimin e listës së dytë në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor nga radhët e avokatëve, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar..... 14487
Vendim i Kuvendit nr. 64/2024, datë 4.7.2024	Për rrëzimin e listës së dytë në bllok të kandidatëve të përzgjedhur për anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga radhët e avokatëve, sipas ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar..... 14487
Vendim i Kuvendit nr. 65/2024, datë 4.7.2024	Për zgjedhjen e zotit Albert Minga anëtar të Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar..... 14487
Rezolutë e Kuvendit datë 4.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2023..... 14488
Rezolutë e Kuvendit datë 4.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2023. 14489
Rezolutë e Kuvendit datë 4.7.2024	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023..... 14491
Udhëzim i përbashkët i ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit nr. 112, datë 9.7.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e përbashkët nr. 28, datë 24.2.2023, “Mbi bashkëpunimin e strukturave të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për garancinë financiare në procedurat e vlerësimit të vizave për të huajt”..... 14492

Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 45, datë 11.6.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-5019, datë 4.10.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimin e procedurave dhe shpërblimin e dëmit. Kohëzgjatjen e paarsyeshme në procedurat e gjyimit të çështjes nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga kjo gjykatë. Konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për përshpejtimin e gjyimit të shpërblimit të dëmit në zbatim të vendimit nr. 3, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese.....	14493
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 47, datë 11.6.2024	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-3297(279), datë 12.9.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.	14499
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 781/10, datë 15.7.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 822, datë 19.12.2022, “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Ndërtimi i linjës 110 kV Burrel–Bulqizë’”.....	14516

**VENDIM
Nr. 63/2024****PËR RRËZIMIN E LISTËS SË DYTË NË
BLLOK TË KANDIDATËVE
TË PËRZGJEDHUR PËR ANËTARË TË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR
NGA RADHËT E AVOKATËVE, SIPAS
LIGJIT NR. 115/2016, “PËR ORGANET
E QEVERISJES SË SISTEMIT TË
DREJTËSISË”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 147, pika 8, të Kushtetutës; të nenit 35, pika 16, të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 55 të Rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës së dytë në bllok të kandidatëve për anëtarë nga radhët e avokatëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, që kanë rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Erind Mërkuri
2. Albens Tabaku

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 4.7.2024.

**VENDIM
Nr. 64/2024****PËR RRËZIMIN E LISTËS SË DYTË NË
BLLOK TË KANDIDATËVE TË
PËRZGJEDHUR PËR ANËTARË TË
KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË NGA RADHËT E
AVOKATËVE SIPAS LIGJIT NR. 115/2016,
“PËR ORGANET E QEVERISJES SË
SISTEMIT TË DREJTËSISË”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 149, pika 8, të Kushtetutës, nenit 35, pika 16, të ligjit nr. 115/2016,

“Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenit 55 të rregullores së Kuvendit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e listës së dytë në bllok të kandidatëve për anëtarë nga radhët e avokatëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, që kanë rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si më poshtë:

1. Artan Reçi

2. Bledar Bajri

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 4.7.2024.

**VENDIM
Nr. 65/2024****PËR ZGJEDHJEN E ZOTIT ALBERT
MINGA ANËTAR TË KËSHILLIT
DREJTUES TË RADIOTELEVIZIONIT
SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës, neneve 93, 94 dhe 100, të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe neneve 55 dhe 111 të rregullores së Kuvendit, me propozim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Albert Minga zgjidhet anëtar i Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar për periudhën e mbetur të mandatit të anëtarit të liruar nga kjo detyrë, që përfundon në datën 22.2.2026.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 4.7.2024.

**REZOLUTË****PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2023****Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke njohur përgjegjësinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për organizimin dhe administrimin e zgjedhjeve dhe referendumeve, mbikëqyrjen e veprimtarive të administratës zgjedhore, monitorimin e veprimtarisë së subjekteve zgjedhore, institucioneve shtetërore dhe të medias në raport me zgjedhjet, si dhe zgjidhjen në rrugë administrative të kërkesave ose ankesave që kanë lidhje me procesin zgjedhor;

Vlerëson veprimtarinë e KQZ-së, gjatë vitit 2023, lidhur me:

Angazhimin e KQZ-së gjatë të gjithë procesit, para, gjatë dhe paszgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023; zgjedhjet e përsëritura në Rrogozhinë në datën 23 korrik 2023; zgjedhjet e pjesshme për kryetarin e Bashkisë Kukës në datën 24 shtator 2023;

Publikimin në faqen *web* të KQZ-së: raporte (të monitorimit të fushatës zgjedhore, raportet financiare të partive politike, si dhe raportet e auditimit) për periudhën janar–dhjetor 2023; vendime të Komisionit të Ankesave dhe Sanksioneve; vendime të Komisionit Rregullator; udhëzime të Komisionerit Shtetëror; urdhra të Komisionerit Shtetëror; vendime të KSHZ-së; urdhra/vendime të Nënkomisionerit; raporte të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe raporte për KQZ-në;

Zhvillimin e Konferencës “Votimi nga jashtë vendit – rruga përpara!”, në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, në kuadër të nxitjes së palëve dhe rritjes së ndërgjegjësimit për mundësimin e votës nga jashtë vendit;

Angazhimin lidhur me shqyrtimin e rezultateve të Prokurorisë së Përgjithshme, për vitin 2023, për procesin e dekriminalizimit për kandidatët për deputetë në Kuvendin e Shqipërisë (2021–2025), për anëtarë në këshillin bashkiak (2023–2027);

Verifikimin e thelluar për kandidatët për zgjedhjet e datës 14 maj 2023;

Angazhimin e KQZ-së, lidhur me zëvendësimin e vakancave të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë për shkak të ndërprerjes së mandatit të deputetëve;

Angazhimin në vendimmarrje për plotësimin e vakancave në ushtrimin e funksionit në këshill

bashkiak gjatë vitit 2023 dhe vitit 2024;

Realizimin e fondeve buxhetore në masën 92% për shpenzimet korrente, realizimin në masën 87% për shpenzime kapitale me financim të brendshëm dhe realizimin në total të buxhetit në masën 92% të planit të parashikuar për vitin 2023;

Realizimin e implementimit të projektit, në bashkëpunim me qeverinë britanike, për rritjen e informimit dhe ndërgjegjësimin të komunitetit rom për zgjedhjet vendore të datës 14 maj 2023;

Nënshkrimin e marrëveshjes me qeverinë zvicerane për projektin, i cili synon rritjen e transparencës dhe efektivitetin e KQZ-së nëpërmjet mjeteve digjitale;

Bashkëpunimin e KQZ-së me Këshillin e Evropës për krijimin e Platformës Elektronike të Raportimit Financiar, që synon përmirësimin dhe rritjen e aksesit në informacion, transparencë, rritjen e cilësisë së të dhënave dhe përpunimit të tyre nga përdoruesit e platformës;

Nisjen e dialogut për bashkëpunimin ndërinstitucional me trupat zgjedhore në rajon dhe agjenci të ndryshme në nivel rajonal, për zgjerimin e përdorimit të instrumenteve digjitale në zgjedhje, me mbështetjen e International IDEA dhe Qendrës për Sundimin e Ligjit të Finlandës;

Pjesëmarrjen e KQZ-së gjatë vitit 2023, me ftesë dhe mbështetje financiare të institucioneve homologe, në vëzhgimin e proceseve zgjedhore lokale, parlamentare dhe presidenciale në vendet e rajonit: Estoni, Gjeorgji, Armeni dhe Moldavi;

Pjesëmarrjen në aktivitete ndërkombëtare në Poloni, Strasburg, Bosnjë-Hercegovinë, Kore e Jugut, Finlandë dhe Gjeorgji.

Kuvendi rekomandon që KQZ-ja, për vitin 2024, të përmirësojë punën në këto drejtime:

1. T'i kushtojë një vëmendje të veçantë dhe konkrete bashkëpunimit me institucionet përkatëse, përfshirë këtu edhe Kuvendin e Shqipërisë, në vijim të përpjekjeve të ndërmarra gjatë vitit 2022 për miratimin e akteve nënligjore në zbatim të Kodit Zgjedhor për të mundësuar votimin e shtetasve shqiptarë, të cilët banojnë jashtë vendit.

2. Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, si dhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve duhet të sigurojnë një vendimmarrje të drejtë, duke shmangur arsyetimet ligjore të paqëndrueshme, duke ulur kështu në vijim numrin e padive të cilat kundërshtojnë vendimmarrjet e tyre.



3. Duhet të marrë masa dhe të trajtojë me prioritet çështjen e mosshqyrtimit të plotë nga audituesit e punësuar të të gjitha raporteve vjetore financiare të partive politike, për shkak të adresave të pasakta. Gjithashtu, duhet të parashikojë fluksin real të raporteve që do të shqyrtohen nga audituesit e licencuar, në mënyrë që të mos punësohen më tepër auditues sesa është e nevojshme, për të evituar kështu dëmin financiar që i shkaktohet fondit të buxhetit të shtetit për financimin e partive politike. KQZ-ja duhet të trajtojë me kujdes procesin e përzgjedhjes së audituesve, duke pasur në fokus qëllimin kryesor që ky proces ka: gjetjet, evidentimin e problematikave dhe marrjen e masave në përputhje me përcaktimet ligjore.

4. Duhet të angazhohet më tepër në kuadër të fushatave të ndërgjegjësimit për procesin e votimit, në veçanti për votuesit për herë të parë, në mënyrë që të ketë një pjesëmarrje më të lartë të kësaj fashe votuesish.

5. Të marrë masa për garantimin e qëndrueshmërisë së administratës zgjedhore, duke rishikuar sistemin e emërimit të anëtarëve dhe sekretarëve të nivelit të ulët.

6. Të angazhohet më tepër në mundësimin e përdorimit të teknologjisë, në mënyrë që zgjedhësit të votojnë të pavarur dhe në fshehtësi të plotë.

7. Të angazhohet më tepër lidhur me informimin e zgjedhësve në mënyrë të vazhdueshme për format dhe mënyrat se si ata mund të denoncojnë shkeljet, si edhe se si ata mund të mbrohen ndaj pasojave; gjithashtu, në afishimin vazhdimisht të listave të zgjedhësve në të gjitha bashkitë.

8. Të garantojë nëpërmjet administratës zgjedhore aksesueshmërinë në qendrat e votimit për personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të kenë akses të pavarur në procesin zgjedhor.

9. Të angazhohet në përmbushjen me efektivitet të detyrimeve institucionale, në kuadër të raportimeve gjatë procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 4.7.2024.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar kontributin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve nën mbikëqyrje;

Duke njohur misionin e Autoritetit për krijimin e një tregu bashkëkohor dhe efektiv, që ofron shërbime cilësore dhe promovon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar jobankar në vend;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Autoritet, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2023 në drejtim të:

Monitorimit të vazhdueshëm të treguesve financiarë për funksionimin efektiv, sigurimin e stabilitetit, promovimin e transparencës të tregjeve nën mbikëqyrje, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe investitorëve të këtyre tregjeve.

Kontributit në mbështetje të procesit *screening* dhe progresit të mëtejshëm në përafrimin e legjislacionit vendas me direktivat dhe rregulloret e BE-së në fushën e shërbimeve financiare, duke marrë vlerësimet përkatëse edhe në raportin e progresit të KE-së për vitin 2023.

Angazhimit institucional në procesin e hartimit dhe miratimit të ligjit nr. 76/2023, “Për fondet e pensionit privat”, tërësisht të harmonizuar me legjislacionin evropian, nisjen e punës për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe përmbylljen e kuadrit rregullator në zbatim të ligjeve që rregullojnë veprimtarinë e tregjeve të kapitalit dhe sipërmarrjeve të investimeve kolektive.

Përmirësimit të metodologjive mbikëqyrëse me bazë risku, veçanërisht për tregun e sigurimeve të jo-jetës, ku nëpërmjet asistencës së Bankës Botërore është punuar në përafrimin me praktikat më të mira ndërkombëtare të identifikimit të hershëm dhe parandalimit të problemeve financiare të shoqërive të sigurimit, si dhe marrjes së masave dhe vendosjes së afateve për hartimin dhe raportimin e pasqyrave financiare në përputhje me standardet ndërkombëtare të raportimit financiar.



Intensifikimit të bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse në fushën e sigurisë kibernetike për minimizimin e rreziqeve të lidhura me të, si dhe përditësimi me teknologjitë e reja dhe shtimi i funksioneve të platformës *online* të raportimit të të dhënave financiare AMF In-Reg.

Nisjes së punës për modernizimin e tregjeve nën mbikëqyrje duke i orientuar investimet e tyre drejt financave të gjelbra dhe në veçanti zhvillimi i obligacioneve shtetërore të gjelbra nëpërmjet angazhimit me projekte dhe aktivitete konkrete me asistencën teknike të partnerëve ndërkombëtarë, të cilat synojnë përgatitjen e një plani veprimi kombëtar për riskun klimatik.

Promovimit dhe zhvillimit të tregjeve të kapitalit jo vetëm nëpërmjet miratimit të strategjisë përkatëse, por edhe me angazhimin e Zyrës së Departamentit Amerikan të Thesarit dhe BERZH-it në projekte të veçanta për funksionimin e tregut korporativ të obligacioneve dhe atë të instrumenteve financiare derivative.

Nxitjes së pjesëmarrjes së investitorëve të huaj në tregjet në mbikëqyrje, ku për vitin 2023 iu dha e drejta dy fondeve të investimit të BE-së për të qenë të pranishme në vendin tonë duke ofruar risi për tregun shqiptar për shkak të karakteristikave ESG (mjedisore, sociale dhe të qeverisjes korporative) që mbartin këto fonde.

Mbikëqyrjes efektive të tregjeve financiare jobankare, duke vijuar me realizimin e 35 inspektimeve *onsite*, marrjen e 28 vendimeve për masa administrative e korrigjuese, nga të cilat 20 vendime janë për tregun e sigurimeve, 3 për tregun e kapitalit, 3 të tjera për tregun e fondeve të pensionit privat dhe SIK dhe 2 për Byronë e Sigurimeve. AMF-ja, referuar masave administrative që ka marrë, ka arritur të sigurojë një vlerë prej 9.8 milionë lekësh si të ardhura nga gjolat.

Angazhimit dhe kontributit të dhënë bashkë me institucionet e tjera lidhur me çështjet e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, të adresuara në raportin e MONEYVAL-it, në bazë të të cilave u arrit progresi i synuar dhe u vendos dalja e Shqipërisë nga lista e juridiksioneve nën monitorimin e shtuar.

Shqyrtimit dhe trajtimit nëpërmjet regjistrit *online* të një numri total prej 160 ankesash të konsumatorëve dhe investitorëve, nga të cilat 95% i përkasin tregut të sigurimeve, e më së shumti sigurimit të detyrueshëm motorik dhe Kartonit

Jeshil. Pas ndërhyrjes së institucionit, janë zgjidhur rreth 46% e ankesave.

Përfitimit të asistencës së vazhdueshme të organizatave ndërkombëtare, si: FMN, IOSCO dhe IOPS, për zhvillimin e kapaciteteve jo vetëm të stafit të institucionit, por edhe të operatorëve të tregut financiar jobankar.

Kuvendi kërkon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2024 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të nisë punën për përgatitjen e ndryshimeve të nevojshme ligjore në ligjin “Për sigurimet dhe risigurimet” në përputhje edhe me rekomandimet e lëna në raportin e vlerësimit të IAIS-it, për përafrimin e mëtejshëm me Parimet Themelore në Sigurime (ICP), duke ndjekur praktikën më të mira globale në mbikëqyrjen e sigurimeve.

2. Të angazhohet në zbatimin gradual të planeve për adoptimin e Solvency II brenda periudhës 7-vjeçare të planifikuar nga AMF-ja, nëpërmjet të cilit do të mund të arrihen ndryshimet e nevojshme në kulturën e administrimit të rrezikut nga ana e shoqërive të sigurimit.

3. Të miratojë aktet rregullatore për tarifimin e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit, ku të përcaktohet që primi i sigurimit të vendoset në varësi të riskut që mbart secili i siguruar.

4. Të mbështesë më tej Ministrinë e Financave për përfundimin e procesit të hartimit të projektligjit “Për sigurimin e detyrueshëm të banesave nga tërmetet”, duke përfshirë në të komentet e sugjerimet e ardhura nga grupet e interesit.

5. Të nxisë shoqëritë e sigurimit në zhvillimin e produkteve të reja që plotësojnë kërkesat e konsumatorit, përmirësimin e produkteve ekzistuese, formave të reja të shpërndarjes dhe marketimit të produkteve, me qëllim zgjerimin e bazës së personave të siguruar, tek kategoritë me të ardhura të ulëta dhe të mesme.

6. Të monitorojë zhvillimet e tregjeve të mbikëqyrura në drejtim të rritjes së transparencës për produktet që iu ofrohen investitorëve, në veçanti për produktet *online*, me qëllim mbrojtjen e tyre.

7. Të rishikojë kërkesat rregullatore lidhur me treguesit në nivel grupi, përfshirë kërkesat e shtuara për përshtatshmëri të personave kyç të grupit dhe ato të lidhur me qeverisjen korporative.

8. Të punojë në drejtim të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* e BE-së, me



rregulloren më të fundit evropiane për tregjet e krypto-aseteve “Markets in Crypto-assets (MiCA)”.

9. Të bashkëpunojë me të gjitha palët e përfshira në proces për implementimin e strategjisë për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, me qëllim rritjen e pjesëmarrjes së emetuesve, zgjerimit të gamës së instrumenteve financiare, përmirësimit të eficiencës së tregut dhe zgjerimit të bazës së investitorit.

10. Të bashkërendojë punën me institucionet e tregut të kapitaleve për hartimin e një kodi të qeverisjes korporative, me qëllim krijimin dhe promovimin e standardeve më të larta të qeverisjes korporative, menaxhimit të riskut dhe të sjelljes.

11. Të përmbyllë procesin për plotësimin e kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit nr.76/2023 “Për fondet e pensionit vullnetar”, për përfundimin e këtij procesi brenda vitit 2024, si dhe të nxisë shoqëritë administruese të fondeve të pensionit për realizimin e përshtatshmërisë së aktivitetit me kërkesat e reja ligjore dhe rregullatore.

12. Të rrisë transparencën, duke pasqyruar në fagen zyrtare të institucionit informacione shtesë që lidhen me veprimtarinë e subjekteve të mbikëqyruara, me qëllim informimin dhe ndërgjegjësimin e publikut.

13. Të nisë punën për miratimin e ndryshimeve ligjore të nevojshme në ligjin nr. 9572, datë 3.7.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, duke marrë parasysh rekomandimet e IAIS-it dhe audituesit të pavarur.

14. Të vijojë inspektimin dhe monitorimin e tregjeve nën mbikëqyrje, me qëllim nxitjen e qëndrueshmërisë dhe zhvillimin e tyre.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 4.7.2024.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE PËR VITIN 2023

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e veçantë të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në qasjen për forcimin e kulturës së garantimit të standardeve më të larta në

ushtrimin në praktikë të të drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale;

Duke vlerësuar rolin aktiv të këtij institucioni në procesin e integritetit në Bashkimin Evropian, specifikisht për kontributin në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale;

Duke vlerësuar veprimtarinë e institucionit në përmbylljen e procesit të përmirësimit të legjislacionit në fushën e të drejtës për informim;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e ngushtë dhe konstant me qytetarë apo grupe interesi, autoritete publike, subjekte juridike në sferën private, organizata të shoqërisë civile dhe medien;

Shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2023 dhe konstatoi se:

Ka realizuar plotësisht rekomandimet e lëna në rezolutën e datës 8.6.2023, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, si dhe rekomandimet e adresuara nga raporti i progresit për vitin 2023 për Shqipërinë.

Ka dhënë kontribut parësor në përmbylljen e procedurave për modernizimin e kuadrit ligjor në fushën e të drejtës për informim nëpërmjet miratimit të ligji nr. 78, datë 21.9.2023, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014, ‘Për të drejtën e informimit’”.

Ka dhënë kontribut aktiv në përmbylljen e procesit për miratimin e legjislacionit të ri në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale në bashkëpunim me partnerët vendës dhe evropianë.

Ka vijuar procesin e monitorimit dhe mbikëqyrjes për verifikimin e përditësimit të Programit të Transparencës të autoriteteve publike, si dhe në ndihmë të tyre ka miratuar udhërrëfyesin për zbatimin e programit institucional të transparencës.

Nëpërmjet procesit të shqyrtimit administrativ të ankesave ka nxitur përmirësimin e transparencës, duke angazhuar autoritetet publike për përmbylljen e detyrimeve në vendosjen në dispozicion të publikut të informacionit.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, ka nxitur dhe dhënë kontribut në hartimin e akteve nënligjore.

Në funksion të zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga subjektet politike ka dhënë kontribut aktiv duke miratuar



udhëzuesin “Për përpunimin e të dhënave personale në kontekstin e fushatave zgjedhore”.

Ka zhvilluar hetime administrative me objekt tematik për zbatimin e masave tekniko-organizative për përpunimin e sigurt të të dhënave personale, veçanërisht për sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit (SMSI), si dhe në fusha e sektorë me ndjeshmëri të lartë.

Është ndjekur me prioritet procesi verifikues i zbatimit të masave të lëna në rekomandimet e mëparshme, si në sferën publike, ashtu edhe në atë private, duke vendosur edhe sanksione administrative në rastet e mospërbushjes së tyre.

Në kuadër të aspektit ndërgjegjësues, është angazhuar në organizimin e aktiviteteve të kësaj natyre në të dyja fushat e përgjegjësisë, edhe në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile, për nxitjen e qytetarëve në ushtrimin e këtyre të drejtave dhe respektimin e tyre nga institucionet publike dhe entitetet private.

Ka luajtur rol aktiv në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar me autoritetet dhe organizatat homologe dhe më gjerë në të dyja fushat e veprimtarisë.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Zyra e Komisionerit për vitin 2024, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të luajë rol aktiv në përmbylljen e procedurave për miratimin e kuadrit ligjor/nënligjor për fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, për të drejtën e informimit, si dhe për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.

2. Të thellojë mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit për të drejtën e informimit, duke pasur si qëllim rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së administratës publike/ shtetërore për garantimin e transparencës proaktive apo nivelit të lartë të aksesit në informacion publik.

3. Të vijojë procesin e monitorimit dhe asistencës në instalimin dhe funksionimin e instrumenteve elektronike, të cilat janë alternativë e vlefshme për forcimin e transparencës së autoriteteve publike.

4. Të ushtrojë hetime të thelluara për zbatimin e detyrimeve të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale si në sferën publike, ashtu edhe në atë private, në fusha e sektorë si ai i arsimit, shëndetësor, bankar, turizmit etj.

5. Të rrisë mbikëqyrjen tematike për masat tekniko-organizative, specifikisht për Sistemin e

Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) në funksion të ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit, disponueshmërisë dhe besueshmërisë në procesin e përpunimit të të dhënave personale.

6. Të rrisë ndërgjegjësimin në funksion të transparencës proaktive, me qëllim uljen e ankesave dhe zbatimin e afateve ligjore në dhënien e informacionit.

7. Të mbikëqyrë dhe monitorojë zbatimin efektiv të rekomandimeve të lëna më herët nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

8. Të angazhohet dhe bashkëpunojë me institucionet përkatëse për forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit të Zyrës së Komisionerit dhe të institucioneve publike/private për përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me fushat e përgjegjësisë, si: të drejtën e informimit, mbrojtjen e të dhënave personale dhe ripërdorimin e informacionit publik dhe menaxhimin e të dhënave të hapura.

9. Të zhvillojë procesin monitorues/mbikëqyrës pranë prokurorive për zbatimin e legjislacionit të fushës dhe detyrimeve që burojnë nga marrëveshja e bashkëpunimit me Eurojust për mbrojtjen e të dhënave personale.

10. Të hartojë një kurrikul profesionale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale si standard për trajnimet apo dhe si një mundësi për zbatim nga sistemi arsimor.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 4.7.2024.

UDHËZIM I PËRBASHKËT Nr. 112, datë 9.7.2024

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN E PËRBASHKËT NR. 28, DATË 24.2.2023, “MBI BASHKËPUNIMIN E STRUKTURAVE TË MINISTRISË PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME, MINISTRISË SË BRENDSHME DHE MINISTRISË SË FINANCË DHE EKONOMISË, PËR GARANCINË FINANCIARE NË PROCEDURAT E VLERËSIMIT TË VIZAVE PËR TË HUAJT”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; nenit 18, pika 4, të ligjit nr. 79/2021,



“Për të huajt”; si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 858, datë 29.12.2021, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me qëllim harmonizimin e procedurave ndërmjet institucioneve përgjegjëse në procesin e përcaktimit të garancisë financiare, në vlerësimin e vizave për të huajt në Republikën e Shqipërisë,

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin e përbashkët nr. 28, datë 24.2.2023, “Mbi bashkëpunimin e strukturave të ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për garancinë financiare në procedurat e vlerësimit të vizave për të huajt”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në kreun I, pika 1 bëhen ndryshimet si vijon:

a) Në shkronjën “a”, togfjalëshi “*Postet konsullore (më poshtë “PDK”)*”, të zëvendësohet me “*Misionet diplomatike dhe postet konsullore (më poshtë “MPDK”)*”;

b) Shkronja “c” të riformulohet si vijon:

“c) *Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (më poshtë “MEKI”).*”

2. Në kreun II, në fund të pikës 2, të shtohet paragrafi si vijon:

“*Përfashtimisht, shuma e garancisë financiare për studentët e huaj të pranuar nga universitetet publike ose private në Republikën e Shqipërisë duhet të jetë jo më pak se 300,000 lekë.*”

3. Në kreun III, pika 1, “*Ministria e Financave dhe Ekonomisë*”, të zëvendësohet me “*Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit*”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM

Taulant Balla

MINISTËR I EKONOMISË KULTURËS
DHE INOVACIONIT

Blendi Gonxhja

MINISTËR PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME

Igli Hasani

VENDIM

Nr. 45, datë 11.6.2024

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Genti Ibrahim	anëtar,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 11.6.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 22 (I) 2023, të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: LAERT KOLA

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

Ministria e Drejtësisë, përfaqësuar nga Xhelal Kasaj, Erjon Ndreca dhe Ornela Marku.

Ministria e Financave, përfaqësuar nga Risena Xhaja.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar nga avokate Irma Qosja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-5019, datë 4.10.2023, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i shkëljes së afatit të arsyeshëm, përshpejtimi i procedurave dhe shpërblimi i dëmit. Kohëzgjatja e paarsyeshme në procedurat e gjykimit të çështjes nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor nga kjo gjykatë.

Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për përshpejtimin e gjykimit të shpërblimit të dëmit në zbatim të vendimit nr. 3, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6/1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 28 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin



e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Genti Ibrahim, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjekteve të interesuara, Ministrisë së Drejtësisë (*MD*), Ministrisë së Financave (*MF*) dhe Avokaturës së Shtetit, të cilat kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 132, datë 14.2.1996 (*vendimi nr. 132/1996*) të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve (*KKKP*), Fier është vendosur, ndër të tjera, njohja e pronësisë së shtetasit J.K. (babai i kërkesit) për një truall me sipërfaqe 5000 m², të ndodhur në fshatin Grecalli, Komuna Qendër, Fier dhe kompensimi me truall fizik i trashëgimtarëve të tij ligjorë.

2. Më datë 11.12.2015, kërkuesi, në cilësinë e trashëgimtarit të shtetasit J.K., i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesëpadi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, regjistrimit të pasurisë nr. 128/1 në emër të Komunës Qendër, Fier dhe detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (*ZVRPP*), Fier të fshijë nga regjistrat publikë të pasurive të paluajtshme subjektin Komuna Qendër, Fier dhe të regjistrojë pronarët e kësaj pasurie sipas vendimit nr. 132/1996 të *KKKP*-së, Fier.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, me vendimin nr. 447, datë 31.3.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi, i cili është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 15037 (31025-04490-86-2016) akti, datë 9.9.2016.

4. Më datë 14.12.2020, kërkuesi, në kushtet që ankimi i tij nuk ishte shqyrtuar ende, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm nga Gjykata Administrative e Apelit, përshpejtimin e

procedurave dhe shpërblimin e dëmit për këtë shkak. Në lidhje me këtë kërkesë, me vendimin nr. 25/22, datë 17.6.2021, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e saj dhe pushimin e gjykimit për kërkimin për shpërblimin e dëmit. Sipas asaj gjykate, në rastin konkret nuk konstatohen zvarritje të qëllimshme dhe mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive, që lidhen me vlerësime dhe qëndrime abuzive të gjyqtarit, por vonesa në shqyrtimin e çështjes së kërkesit është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret, e lidhur me efektet e reformës në drejtësi (*shih paragrafët 23, 27 dhe 28 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

5. Më datë 12.10.2021, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor si rezultat i mosgjykimit të çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit brenda një afati të arsyeshëm.

6. Me vendimin nr. 3, datë 17.2.2022 (*vendimi nr. 3/2022*) Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës, shfuqizimin e vendimit të Kolegjit Administrativ, konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm në Gjykatën Administrative të Apelit dhe detyrimin e kësaj të fundit për të gjykuar çështjen e kërkesit brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit.

7. Për sa i përket çështjes së themelit, me vendimin nr. 591, datë 7.12.2022, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur pranimin e padisë dhe detyrimin e palës së paditur, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, që të regjistrojë, në përputhje me vendimin nr. 132/1996 të *KKKP*-së, Fier, pasurinë nr. 128/1, ZK 1453, të regjistruar në emër të Komunës Qendër, Fier.

8. Ndërkohë, më datë 8.4.2022, pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 3/2022 të Gjykatës, kërkuesi i është drejtuar gjykatës me padi me objekt shpërblimin e dëmit si rezultat i konstatimit të cenimit të së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në Gjykatën Administrative të Apelit. Në lidhje me këtë padi, me vendimin nr. 4211, datë 5.8.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur pranimin pjesërisht të saj, duke detyruar palët e paditura, MD-në dhe MF-në, që të paguajnë në favor të kërkesit shumën 300,000 (treqind mijë) lekë, si shpërblim për dëmin



jopasuror të pësuar për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të çështjes së tij gjyqësore. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim kërkuesi dhe Avokatura e Shtetit.

9. Më datën 18.10.2022, në Gjykatën e Apelit Tiranë është regjistruar ankimi nr. 8372 regj., datë 18.10.2022. Ndërsa më datë 10.3.2023, kërkuesi ka paraqitur në gjykatën e apelit kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes dhe në vijim, më datë 6.9.2023, i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm të shqyrtimit të ankimit, përshpejtimin e shqyrtimit të tij dhe shpërblimin e dëmit.

10. Me vendimin nr. 00-2023-5019, datë 4.10.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se gjykata e apelit është në pamundësi objektive të urdhërojë marrjen e masave për përshpejtimin e kësaj çështjeje, pasi është e ngarkuar me çështje të tjera më të vjetra se ajo dhe me të njëjtën apo me shkallë më të lartë përparësie. Sipas Kolegjit Civil, sipas nenit 399/2 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), afati i zakonshëm i gjykimit në apel është dy vjet dhe veçantia e çështjes nuk është reflektuar nga ligjvënësi me parashikimin e afateve ligjore të posaçme në gjykimin në apel, ndaj ky boshllëk ligjor nuk mund të shërbejë si shkak për të penalizuar gjykatën e apelit me konstatimin e shkeljes së gjykimit brenda afatit të arsyeshëm (*shih paragrafin 34 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

11. Më datë 20.12.2023, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Me vendimin e datës 1.3.2024, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

12.1 *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi çështje të kësaj natyre duhet të shqyrtohen brenda tre muajve nga data e regjistrimit, në përputhje me parashikimet e nenit 399/7, pika 1, të KPC-së. Pavarësisht se ka kaluar më shumë se një vit nga regjistrimi i çështjes, gjykata e apelit nuk ka marrë asnjë hap për gjykimin e saj. Gjykata e Lartë

ka përdorur justifikimin e reformës në drejtësi, duke anashkaluar vendimin nr. 78, datë 30.5.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ) që ka përcaktuar çështjet që kanë përparësi në gjykim. Sipas Gjykatës së Lartë, e drejta e kërkuetit është vendosur me vendimin nr. 591, datë 7.12.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit, ndërkohë që kjo nuk është e vërtetë, pasi vendimi nuk është zbatuar. Për më tepër, sipas Gjykatës së Lartë nuk ka afat për gjykimin e çështjes nga gjykata e apelit, pasi dispozita ligjore ka boshllëk.

12.2 Institucionet e përfshira në këtë çështje po përpiqen në çdo formë për të zvarritur procesin gjyqësor, i cili është jashtë afatit ligjor të gjykimit. Padia për shpërblimin e dëmit është paraqitur në gjykatën e rrethit më datë 8.4.2022 dhe vendimi i asaj gjykate është marrë më datë 5.8.2022, pra në tejkalim të afatit të gjykimit të përcaktuar nga ligjvënësi, duke u përdorur si justifikim mosfunksionimi i faqes elektronike të Qendrës së Botimeve Zyrtare, e cila nuk ka funksionuar vetëm në datat dhe orën e seancave gjyqësore.

13. **Subjekti i interesuar, MD-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

13.1 Me ndryshimet e vitit 2017 në KPC janë shtuar nenet 399/1-399/12, të cilat kanë krijuar një mekanizëm efektiv, ku synimi parësor nuk është dëmshpërblimi monetar i palëve në proceset e tejzgjatura, por parandalimi i kësaj tejzgjatjeje nëpërmjet mekanizmave për përshpejtimin e procedurave, me qëllim dhënien e drejtësisë në kohë të arsyeshme. Ky mekanizëm ka bërë kompetente për shqyrtimin e kërkesave për shpërblim të drejtë gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, ndërkohë që interpretimi kushtetues është kompetencë e Gjykatës.

13.2 Kërkuesi nuk e ka konceptuar drejt parashikimin e nenit 399/7 të KPC-së, pasi afati tremujor i referohet gjykimit në gjykatën e shkallës së parë, ndërkohë që kjo dispozitë nuk përmban ndonjë parashikim për gjykimin në shkallët e tjera, duke konsideruar se në to zbatohen rregullat e zakonshme të gjykimit. Çështja e kërkuetit është regjistruar më datë 18.10.2022, ndaj afati ligjor për gjykimin e saj nuk është tejkaluar ende. Gjykata e apelit është në pamundësi objektive për të urdhëruar marrjen e masave për përshpejtimin e çështjes, pasi ajo është e ngarkuar me shumë çështje të tjera më të vjetra se ajo e kërkuetit me të njëjtën apo me shkallë më të lartë përparësie.



13.3 Kërkesa për shpërblimin e dëmit është e pabazuar, pasi ajo nuk mund t'i drejtohet Gjykatës, e cila shprehet vetëm për procesin e rregullt ligjor dhe nuk mund të caktojë shpërblim monetar. Për sa kohë gjykata e apelit nuk është në shkelje të afatit të arsyeshëm, nuk ka vend për të kërkuar dëmshpërblim.

14. **Subjekti i interesuar, MF-ja**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

14.1 Përfshirja e MF-së në procesin e shpërblimit të dëmit për shkak të konstatimit të tejkalimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit të çështjes dikton nevojën që të vihet në pah raporti që ekziston mes së mirës individuale dhe së mirës së përgjithshme në drejtim të prekjes së buxhetit të shtetit, si dhe në drejtim të përballjes së sistemit gjyqësor me ngarkesë të përgjithshme të çështjeve gjyqësore, që nuk prek individë të veçantë, por përbën një situatë të përgjithshme. Qëllimi i parashikimeve ligjore që normojnë këtë situatë nuk mund të kufizohet në interpretim të ngushtë të tyre, pasi kjo do të sillte një pasojë negative, humbjen e qëllimit të tyre dhe disbalancë në raport me situatën objektive të përgjithshme të krijuar nga mbingarkesa e sistemit gjyqësor.

14.2 Në rastin e kërkuarit, referuar nenit 399/1 të KPC-së, afati i shqyrtimit të çështjes prezumohet se plotësohet më datë 18.10.2024, pra pas kalimit të dy vjetëve nga regjistrimi i saj në gjykatën e apelit. Pra, nuk ndodhemi përpara një shkeljeje të qëllimshme, por përpara një situatë objektivisht të ngarkuar të sistemit gjyqësor, përfshirë gjykatën e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, si pasojë e riorganizimit gjyqësor me miratimin e hartës së re gjyqësore dhe mbylljen e gjykatave të apelit. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i drejtë, sepse nuk jemi përpara kohëzgjatjes së paarsyeshme në procedurat e gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit.

15. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

15.1 Referuar nenit 399/7 të KPC-së nuk plotësohet kriteri i kalimit të afatit dyvjeçar nga regjistrimi i çështjes në gjykatën e apelit deri në paraqitjen e kësaj kërkesë. Vonesa në shqyrtimin e mosmarrëveshjes konkrete objekt gjykimi është rrjedhojë e një problematike të përgjithshme që tejkalon rastin konkret. Kërkuari e ka realizuar të drejtën e tij në themel për çështjen për të cilën është konstatuar shkelja e afatit të arsyeshëm nga Gjykata. Pretendimet e ngritura nga kërkuari kanë të bëjnë

me afatin e arsyeshëm të gjykimit të kërkesës për shpërblimin e dëmit, kurse pretendimet për mosekzekutimin e vendimit nr. 591, datë 7.12.2022, të Gjykatës Administrative të Apelit dalin tej objektit të gjykimit dhe kërkuari për to ka mjete të tjera procedurale. Tejzgjatja e procedurave gjyqësore nuk paraqet shkallë rreziku për interesin e kërkuarit.

15.2 Mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime në kundërshtim me ligjin të gjyqtarit. Shqyrtimi i çështjeve nga gjykata, në respektim të parimit të prioritetit në kohë, realizohet duke marrë në konsideratë çështjen më të hershme të regjistruar. Analiza dhe arsyetimi i vendimit të Gjykatës së Lartë janë ezaurues dhe të plotë, duke u dhënë në mënyrë të argumentuar me referenca ligjore dhe jurisprudencë kushtetuese përgjigje të gjitha kërkesave të ngritura në kërkesën objekt gjykimi.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuarit

16. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "F" dhe 134, pikat 1, shkronja "I" dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

17. Në drejtim të legjitimitimit *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja "F" dhe 134, pikat 1, shkronja "I" dhe 2, të Kushtetutës, Gjykata, kur ka shqyrtuar ankime për të drejtën e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm, ka pohuar se, në parim, statusi i "viktimës" përjashtohet vetëm nëse organet publike kanë njohur shkeljen, në mënyrë të shprehur ose në substancë, dhe më pas e kanë riparuar atë



(shih vendimin nr. 44, datë 26.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese).

18. Mbi bazën e këtij standardi, Gjykata vlerëson se kërkuesi, edhe pse ai ka një vendim të gjykatës së shkallës së parë që i ka njohur të drejtën e shpërblimit për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor të shqyrtimit të padisë së themelit, që përbën një masë të favorshme ndaj tij, kërkuesi jo vetëm që nuk ka mundur ta ekzekutojë vendimin, por është ende në pritje të shqyrtimit të çështjes në gjykatën e apelit, e vënë në lëvizje mbi bazën e ankimit të tij. Në këto kushte, kërkuesi nuk e ka humbur statusin e viktimës, në drejtim të përshtatshmërisë dhe efektivitetit të mjetit kompensues. Për rrjedhojë, kërkuesi legjitimohet *ratione personae* pasi provon interesin e drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

19. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “P” i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, Gjykata ka theksuar se, bazuar në nenin 42 të Kushtetutës, kur ajo shqyrton pretendimet për tejzgjatjen e mjetit juridik riparues/korrigjues, individit nuk mund t’i kërkohej që edhe gjatë këtij procesi të përdorë apo të sherojë mjetet juridike që parashikojnë nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Një qëndrim i ndryshëm do të bënte që këto mjete të humbnin qëllimin e tyre dhe do t’i vinin individit një barrë të tepruar, pasi do e detyronin atë të vinte lëvizje procese gjyqësore për të siguruar shpejtësinë dhe efektivitetin e një mjeti që në vetvete ka për qëllim përshpejtimin dhe parandalimin e shkeljes së kohëzgjatjes së paarsyeshme të procesit gjyqësor (shih vendimin nr. 44, datë 26.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese). Për këtë arsye, edhe pse kërkuesi, formalisht, ka paraqitur në gjykatat e zakonshme kërkesë për konstatimin e vonesës në shqyrtimin e çështjes së tij civile, një rrethanë e tillë nuk është e rëndësishme në drejtim të legjitimitetit të tij në aspektin kushtetues, pasi ky lloj gjykimi nuk kërkon shterimin e mjeteve juridike. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret kërkuesi legjitimohet t’i drejtohet asaj drejtpërdrejt me kërkesë për të shqyrtuar efektivitetin e mjetit kompensues, në drejtim të kohëzgjatjes.

20. Në lidhje me kriterin *ratione temporis*, të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit kërkesa paraqitet brenda afatit 4-mujor nga konstatimi i cenimit, Gjykata ka theksuar se kur shkelja e pretenduar

përbën një situatë të vazhdueshme kundër së cilës nuk ka mjete juridike të brendshme, afati i ankimit fillon të ecë vetëm kur kjo situatë përfundon (shih vendimin nr. 44, datë 26.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese). Për këtë arsye, duke pasur parasysh se çështja e kërkuesit në gjykatën e apelit nuk është shqyrtuar ende dhe duke qenë se në rastin konkret vihet në diskutim efektiviteti i mjetit juridik kompensues, kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis* për të vënë në lëvizje gjykimin kushtetues.

21. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, kërkuesi ka kërkuar konstatimin e cenimit të së drejtës për proces të rregullt ligjor, si rezultat i mosgjykimit brenda afatit të arsyeshem nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë të çështjes së tij për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka vendosur shpërblimin e dëmit për shkak të kohëzgjatjes së paarsyeshme të gjykimin të themelit. Po kështu, ai ka pretenduar edhe konstatimin e mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin e gjykimin në gjykatën e apelit. Për rrjedhojë, në vështrim të neneve 42 të Kushtetutës dhe 13 të KEDNJ-së, pretendimet e kërkuesit Gjykata do t’i shqyrtojë në vijim në drejtim të efektivitetit të mjetit juridik kompensues.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për konstatimin e shkeljes së të drejtës për proces të rregullt për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues

22. Sipas kërkuesit, çështje të kësaj natyre duhet të shqyrtohen, në përputhje me parashikimet e nenit 399/7, pika 1, të KPC-së, brenda tre muajve nga data e regjistrimit. Pavarësisht se ka kaluar më shumë se një vit nga regjistrimi i çështjes në gjykatën e apelit, ajo nuk ka ndërmarrë hapa për gjykimin e saj. Gjykata e Lartë ka përdorur justifikimin e reformës në drejtësi, duke anashkaluar vendimin e KLGJ-së që ka përcaktuar çështjet që kanë përparësi në gjykim. Sipas Gjykatës së Lartë nuk ka afat për gjykimin e çështjes nga gjykata e apelit, pasi dispozita ligjore ka boshllëk.

23. Subjekti i interesuar, MD-ja, ka prapësuar se kërkuesi nuk e ka konceptuar drejt parashikimin ligjor të nenit 399/7 të KPC-së, pasi afati tremujor i referohet gjykimin të padisë për dëmshpërblim në gjykatën e shkallës së parë, ndërkohë që nuk ka ndonjë parashikim ligjor për gjykimin në shkallët e tjera. Neni 399/7 i KPC-së këtë lloj padie e konsideron si një kërkesë që u nënshtrohet



rregullave të zakonshme të gjykimit. Çështja e kërkesit është regjistruar në gjykatën e apelit më datë 18.10.2022, pra afati ligjor për gjykimin e saj nuk është plotësuar ende.

24. Subjekti i interesuar, MF-ja, ka prapësuar se sipas nenit 399/1 të KPC-së afati për shqyrtimin e çështjes prezumohet se plotësohet më datë 18.10.2024, pas kalimit të dy viteve nga momenti i regjistrimit të saj. Për më tepër që në rastin konkret jemi përpara një situatë objektivisht të ngarkuar të sistemit gjyqësor, e njohur tashmë edhe në gjykatën e apelit, si pasojë e riorganizimit gjyqësor me miratimin e hartës së re gjyqësore dhe mbylljen e gjykatave të apelit. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i drejtë, sepse nuk jemi në kushtet e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe nuk jemi përpara kohëzgjatjes së paarsyeshme në procedurat e gjykimit të çështjes nga gjykata e apelit.

25. Sipas subjektit tjetër të interesuar, Avokaturës së Shtetit, kërkuesi e ka realizuar të drejtën e tij në themel për çështjen për të cilën është konstatuar shkelje e afatit të arsyeshëm nga Gjykata. Tejzgjatja e procedurave gjyqësore nuk paraqet rrezik për interesin e kërkesit dhe mosveprimi i gjykatës së apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime dhe qëndrime në kundërshtim me ligjin të gjyqtarit. Shqyrtimi i çështjeve nga gjykata në respektim të parimit të prioritetit në kohë realizohet duke marrë në konsideratë çështjen më të hershme të regjistruar.

26. Gjykata ka pohuar se padia për kompensim për dëmin e shkaktuar nga tejzgjatja e gjykimit duhet të shqyrtohet brenda një afati të arsyeshëm dhe se këto procedura duhet të kryhen në mënyrë të menjëhershme, në mënyrë që zgjidhja të mbetet efektive. Në lidhje me këtë aspekt duhet të mbahet në konsideratë shqyrtimi i kësaj padie sipas rregullave të posaçme, të cilat ndryshojnë nga ato të padisë së zakonshme për shpërblim dëmi, për të shmangur rrezikun - në rastin kur shqyrtohen sipas rregullave të përgjithshme të procedurës civile - që zgjidhja të mos jetë mjaftueshëm e shpejtë. Në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së në rastin e një mjeti kompensues që ka për qëllim të riparojë pasojat e tejzgjatjes së procedurave, periudha kohore e shqyrtimit të tij nuk mund të tejkalojë një afat të arsyeshëm, pasi kjo do e zhvishte atë nga çdo efekt praktik. Në këtë kuptim, çdo interpretim i ngushtë i nenit 42 të Kushtetutës dhe i nenit 6 të KEDNJ-së nuk përputhet me

qëllimet dhe objektin e tyre (*shih vendimin nr. 44, datë 26.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Neni 399/7 i KPC-së ka përcaktuar afatin 3-mujor për gjykimin e kërkesëpadisë për shpërblimin e dëmit nga depozitimi i saj. Edhe pse kjo dispozitë, e parë së bashku me nenin 399/6, pika 3, të KPC-së, shprehet për shqyrtimin e kërkesëpadisë dhe nuk i referohet shqyrtimit të ankimit, qasja e ofruar nga Gjykata e Lartë dhe gjykata e apelit në interpretimin e kësaj dispozite nuk përputhet me përmbajtjen dhe qëllimin e dispozitave që kanë rregulluar mjetet mbrojtëse korrigjuese/kompensuese, të cilat kanë synuar që këto lloj gjykimesh jo vetëm të riparojnë shkeljen e së drejtës për një gjykim brenda afatit të arsyeshëm, por që kjo të sigurohet në një kohë sa më të shpejtë. Në këtë situatë, Gjykata rithekson se çdo qëndrim i ndryshëm nuk do të përputhej me qëllimin e ligjvënësit dhe do të vinte në dyshim efektivitetin e këtyre mjeteve (*shih vendimin nr. 44, datë 26.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Gjykata vëren se sipas Gjykatës së Lartë, në kushtet kur Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë në muajin shkurt të vitit 2023 ka bërë bashkimin e të gjitha dosjeve të mbartura nga gjykatat e tjera të apeleve dhe rishortimit të tyre, është bërë e pamundur që të shqyrtohen me procedurë të përshpejtuar çështjet e mbërritura në vitin 2022, sikurse është edhe çështja e pretenduar nga kërkuesi. Sipas asaj gjykatë, rishortimi dhe bashkimi i të gjitha gjykatave të apelit ka evidentuar emergjencën e shqyrtimit sa më të shpejtë të çështjeve më të vjetra në kohë të regjistruara në gjykatë prej vitit 2016 dhe nisur nga gjendja e ngarkesës së gjykatës së apelit, në veçanti e gjyqtarës relatores, vonesat aktuale lidhen me pamundësinë objektive për procedim, gjë që e bën të pamundur marrjen e masave të përshpejtimit të çështjes dhe për rrjedhojë konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm (*shih paragrafët 24–25 të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë*).

29. Për sa më sipër, duke pasur parasysh natyrën e këtyre mjeteve, Gjykata rithekson se çdo interpretim i gjykatave të zakonshme që do të çonte në kohëzgjatje të tepruar të procesit gjyqësor në gjykatën e apelit, duke penguar palën që i është njohur e drejta e shpërblimit të dëmit për të ekzekutuar vendimin e saj, përbën, në thelb, një kohëzgjatje të tepruar. Gjykata rithekson se gjykimi i këtyre lloj çështjesh, përfshirë edhe në gjykatën e apelit, duhet të jetë i shpejtë dhe ai nuk mund t'u



nënshtrohet afateve të përgjithshme të gjykimit. Ky ka qenë edhe synimi i ligjvënësit kur në nenet 399/1 e vijues të KPC-së ka parashikuar afate të posaçme, të shkurtra, për shqyrtimin e mjeteve mbrojtëse të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në veçanti, neni 399/7, pika 1, i KPC-së ka parashikuar një afat të posaçëm 3-mujor për gjykimin e mjetit kompensues në shkallë të parë, afat ky që meriton të mbahet parasysh edhe për gjykimin në apel (*shih vendimin nr. 44, datë 26.9.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Për sa më sipër, Gjykata vëren se qëndrimi i gjykatave të zakonshme është bazuar mbi argumentet e përgjithshme të pasojave të ristrukturimit të gjykatës së apelit dhe ngarkesës së gjyqtarit relator, ashtu edhe mbi mungesën e një parashikimi ligjor në drejtim të afatit të zbatueshëm për këtë lloj gjykimi në gjykatën e apelit në kundërshtim me standardet e mësipërme të vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese. Gjykata thekson se gjatë zbatimit të ligjit në ushtrim të funksionit të tyre shfaqen edhe si interpretueset e para të normës ligjore dhe se ato nuk kanë asnjë pengesë që të interpretojnë parashikimet ligjore në përputhje me qëllimin dhe frymën e ligjvënësit, për të garantuar zhvillimin e procesit brenda afateve sa më të shpejta. Në këtë kuptim, interpretimi i ngushtë që gjykatat i kanë bërë përmbajtjes së nenit 399/7 të KPC-së cenon vetë thelbin e së drejtës kushtetuese të një individi për të pasur një gjykim të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm në drejtim të mjetit efektiv.

31. Gjykata vlerëson, gjithashtu, të theksojë se konstatimi prej saj i shkeljes së të drejtës për një proces të rregullt për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues synon të mundësojë rivendosjen sa më shpejt të së drejtës së shkelur përmes përshpejtimit të procesit në gjykatën e apelit, duke zbatuar kjo e fundit dispozitat procedurale në përputhje me kuptimin e mësipërm. Nga ana tjetër, ky konstatim nuk përbën njohje të një shkeljeje të re në procesin gjyqësor, pra nuk nënkupton se i njeh kërkuessit të drejta të tjera në lidhje me afatin e arsyeshëm.

32. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuessit në lidhje me mungesën e efektivitetit të mjetit kompensues janë të bazuara, sipas arsyetimit të këtij vendimi, ndaj kërkesa pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konstatimin e shkeljes së të drejtës për proces të rregullt për shkak të mungesës së efektivitetit të mjetit kompensues.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 11.6.2024.

Shpallur, më 11.7.2024.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Elsa Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Ilir Toska

VENDIM

Nr. 47, datë 11.6.2024

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, më datë 11.6.2024 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 64 (A) 2023, të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Arlinda Mulgeci



SUBJEKTE TË INTERESUARA: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm Genti Gazheli.

Ministria e Financave, përfaqësuar nga sekretarja e përgjithshme Risen Xhaja.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3297(279), datë 12.9.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Dërgimi i çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, pika 2, 18, pika 1, 33, pika 1, 41, pikat 1 dhe 2, 42, 131, pika 1, shkronja “F”, 134, dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuësës, e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD) dhe Ministrisë së Financave (MF), që kanë kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja Arlinda Mulgeci (*kërkuësja*) ka qenë punonjëse në DPD nga viti 2003 deri në vitin 2013 në pozicione të ndryshme, së fundmi me detyrë zëvendësdrejtoreshë e përgjithshme e Departamentit të Teknologjisë dhe Informacionit. Me shkresën e datës 16.12.2013, drejtori i përgjithshëm i DPD-së, për arsye të rristrukturimit të këtij institucioni, i ka propozuar ministrit të Financave lirim nga detyra të kërkuësës, propozim i cili është miratuar me shkresën e datës 19.12.2013 të ministrit të Financave. Në vijim, me vendimin nr. 22910/4, datë 31.12.2013, drejtori i përgjithshëm i DPD-së ka vendosur zgjidhjen e marrëdhënies së punës midis

kërkuësës dhe DPD-së, përfundimin e kësaj marrëdhënieje më datë 31.12.2013, pagimin ndaj saj të detyrimeve financiare që kishin të bënin me vjetërsinë në punë, afatin e njoftimit, si dhe ditët e pakryera të lejes vjetore për vitin 2013, në përputhje me nenet 143 dhe 154 të Kodit të Punës.

2. Më datë 4.2.2014, kërkuësja ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke kërkuar anulimin e vendimit nr. 22910/4, datë 31.12.2013 të DPD-së për zgjidhjen e kontratës së punës, detyrimin e punëdhënësit të paditur për ta dëmshpërblyer për zgjidhjen e menjëhershme e të pajustificuar të kontratës së punës, për afatin e njoftimit, vjetërsinë në punë, lejen vjetore të pakryer, si dhe kthimin në vendin e mëparshëm të punës.

3. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 3148, datë 12.6.2014, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në ligj dhe në prova. Ajo gjykatë ka vlerësuar si të pabazuar pretendimet e kërkuësës për anulimin e vendimit të drejtorit të përgjithshëm të DPD-së, me arsyetimin se, referuar edhe vendimit unifikues nr. 7, datë 1.6.2011 të Gjykatës së Lartë, ky vendim nuk është akt administrativ, por shfaqje e vullnetit të administratës publike me cilësinë e punëdhënësit për zgjidhjen e kontratës së punës, për të cilën mund të kërkohej rregullimi i pasojave. I pabazuar është gjetur edhe pretendimi për kthimin në vendin e mëparshëm të punës, duke arsyetuar gjykata se e drejta e rikthimit në punë, bazuar në vendimet unifikuese nr. 8, datë 12.9.2007 dhe nr. 31, datë 14.4.2003 të Gjykatës së Lartë nuk gëzon mbrojtje ligjore. Për sa i përket rregullimit të pasojave nga zgjidhja e kontratës së punës, gjykata është shprehur se në rastin konkret ligji i zbatueshëm është Kodi i Punës, referuar të cilit jemi përpara zgjidhjes së rregullt të kontratës së punës me afat të pacaktuar nga ana e punëdhënësit, nëse plotësohen dy kërkesa: i) respektimi i procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës sipas nenit 144 të Kodit të Punës; ii) respektimi i afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës sipas nenit 143 të po këtij kodi. Për procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës, gjykata ka konstatuar se paditësja (kërkuësja) nuk ka ngritur pretendime, në këtë mënyrë kjo procedurë në rastin konkret është respektuar. Ndërsa për afatin e njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, gjykata ka evidentuar se ky afat në rastin konkret ka qenë 3 muaj, afat i cili është respektuar në rrethanat



kur, referuar shkresës nr. 2765, datë 31.1.2014, të Drejtorisë së Financës pranë DPD-së, rezulton se paditëses (kërkueses) i është paguar paga për afatin e njoftimit, shpërblimi për vjetërsinë në punë dhe leja vjetore e pakryer për vitin 2013. Për rrjedhojë, sipas gjykatës, zgjidhja e kontratës së punës nga punëdhënësi është kryer në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Punës për zgjidhjen normale të kontratës së punës me afat të pacaktuar, ndaj paditësja (kërkuesja) nuk gëzon të drejtën e pretenduar të dëmshpërblimit. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesja.

4. Me vendimin nr. 286, datë 18.2.2016, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pranimin e pjesshëm të padisë, duke detyruar palët e paditura që ta dëmshpërblejnë kërkuesen me 12 paga mujore për shkak të zgjidhjes së menjëhershme për shkaqe të pajustificuara të kontratës së punës. Edhe gjykata e apelit ka arritur në të njëjtin përfundim në lidhje me ligjin e zbatueshëm në rastin konkret, që, sipas saj, referuar interpretimit unifikues të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 19, datë 15.11.2007 (*vendimi unifikues nr. 19/2007*), kontrata e punës është zgjidhur nga punëdhënësi i paditur në kundërshtim me parashikimet e Kodit të Punës, në mosrespektim të afatit 3-mujor të njoftimit, ndaj cilësohet si e menjëhershme. Po sipas gjykatës së apelit, duke qenë se nga të dyja palët ndërgjyqëse është pranuar se kërkuesja është paguar për afatin e njoftimit me 3 paga mujore, shpërblimin për vjetërsinë në punë, si dhe për lejen vjetore të vitit 2013, kërkimet për këto pretendime janë vlerësuar të pabazuara. Në lidhje me shkaqet e zgjidhjes së kontratës së punës, gjykata, bazuar në nenin 153 të Kodit të Punës, ka vlerësuar se riorganizimi strukturor i palës së paditur dhe shkurtimi i funksionit organik nuk përbëjnë shkak të justifikuar për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës. Për këtë arsye, bazuar në nenin 155 të Kodit të Punës, paditësja (kërkuesja) gëzon të drejtën e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës. Kundër këtij vendimi kanë ushtruar rekurs DPD-ja dhe MF-ja, ndërsa kërkuesja ka paraqitur kundërrekurs.

5. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2023-3297(279), datë 12.9.2023, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të

vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke arsyetuar se qëndrimi i mbajtur nga gjykata e apelit është i gabuar dhe nuk përputhet me parashikimet e ligjit material. Sipas atij kolegji, në zgjidhjen normale të kontratës së punës, punëdhënësi është i detyruar të zbatojë nenin 144 të Kodit të Punës, i cili lidhet edhe me respektimin e afatit të njoftimit, sipas nenit 143, pika 1, të këtij kodi. Kërkuesja ka përfituar 3 muaj pagë për efekt të afatit të njoftimit, çka tregon se pala e paditur ka respektuar detyrimin për njoftimin e saj. Në këtë mënyrë, duke respektuar kërkesat e neneve 143, 144 dhe 145 të Kodit të Punës, kontrata e punës konsiderohet e zgjidhur normalisht, në respektim të nenit 141 të Kodit të Punës, referuar kjo edhe në vendimin unifikues nr. 19/2007 të Gjykatës së Lartë. Po sipas Kolegjit Administrativ, me të drejtë, gjykata e shkallës së parë nuk e ka legjitimuar kërkuesen në kërkimin e saj për dëmshpërblimin prej 12 pagash për përfundimin e marrëdhënies së punës, pasi zgjidhja e kontratës së punës nuk është as në kushtet e zgjidhjes së menjëhershme të pajustificueshme, referuar nenit 155 të Kodit të Punës dhe as për motive abuzive, në referim të nenit 146 të këtij kodi.

6. Më datën 28.12.2023 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit. Kolegji i Gjykatës, më datë 12.2.2024, bazuar në nenin 21, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

7. Gjykata, duke pasur në vëmendje se Këshilli i Ministrave i ka kaluar MF-së kompetencat e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), emrat ose akronimet e këtyre institucioneve në tekstin e këtij vendimi janë përdorur në përkëmbim respektiv të njëri-tjetrit, duke iu referuar kohës që janë kryer veprime prej tyre.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

8. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1 *Së drejtës së aksesit dhe asaj për t'u njoftuar*, pasi sipas njoftimit të datës 24.7.2023 në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë çështja do të shqyrtohej nga Kolegji Administrativ në dhomë këshillimi më datë



12.9.2023 dhe po në këtë datë është njoftuar edhe shpallja e vendimit, duke mos u respektuar në këtë mënyrë dispozitat e Kodit të Procedurës Civile (KPC).

8.2 *Parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë nuk ka analizuar kundërrekursin e kërkuësës. Gjykata e Lartë i ka vlerësuar të ligjshme pretendimet e parashtruara nga pala e paditur, DPD-ja dhe MF-ja, pa argumentuar për kundërshtimet e paraqitura nga kërkuësja. Në vendimin e Gjykatës së Lartë nuk parashtrihen dhe nuk trajtohen me hollësi argumentet e saj.

8.3 *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të rekursit të përcaktuara në nenin 58, shkronja "a", të ligjit nr. 49, datë 3.5.2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (ligji nr. 49/2012). Ajo nuk e ka shqyrtuar çështjen mbi bazën e shkaqeve të rekursit, por është investuar pa të drejtë tek afati i njoftimit dhe te shkaku i ndërprerjes së marrëdhënies së punës, çka nuk referohet në rekursin e DPD-së. Po kështu, në rekurs, MF-ja nuk ka paraqitur argumente bindëse kundër vendimit të gjykatës së apelit, ndonëse pranon se duhej respektuar afati i njoftimit. Gjykata e Lartë shprehet se rekursi i palëve të paditura ngre shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, pasi gjykata e apelit është në linjë të gabuar arsyetimi, ndërkohë që në rekurse nuk ka analizë për aplikim të gabuar të ligjit material.

8.4 *Parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar (res judicata)*, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim dhe ka ndryshuar një vendim i cili kishte mbi 7 vjet që ishte ekzekutuar vullnetarisht. Gjykata e Lartë nuk ka kompetencë rishikuese ndaj vendimit të apelit, i cili i ka trajtuar problematikat dhe u ka dhënë zgjidhje atyre.

8.5 *Së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, pasi nga Gjykata e Lartë nuk është respektuar afati ligjor i gjykimit të çështjes.

8.6 *Parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ nuk ka marrë parasysh jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, është kontradiktor me vendimmarrjen në raste të ngjashme, duke mbajtur në këtë mënyrë standard të dyfishtë. Për çështje të njëjta ky kolegji ka arritur në konkluzione diametralisht të kundërta, referuar edhe

jurisprudencës së të njëjtit kolegji me të njëjtën përbërje, konkretisht në vendimet nr. 00-2023-471(89) datë 22.2.2023, nr. 00-2023-119(22), datë 24.1.2023 dhe nr. 00-2023-1832(287), datë 11.5.2023. Në raste të ngjashme, Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh rekursin e paraqitura nga administrata publike. Mendimi i pakicës në vendimmarrjen objekt gjykimi është konform jurisprudencës së këtij kolegji.

8.7 *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi Gjykata e Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim dhe nuk i ka vlerësuar shkaqet e rekursit, sipas përcaktimeve në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012. Ajo ka vlerësuar se rekursi ngre shkaqe nga ato të përcaktuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, pa specifikuar se në cilën pikë të kësaj dispozite e bazon këtë vlerësim. Gjithashtu, Gjykata e Lartë nuk ka kryer kalimin procedural sipas nenit 199 të KPC-së nga MF-ja në MFE. Ajo nuk ka zbatuar vendimin unifikues nr. 19/2007 të Kolegjeve të Bashkuara, i cili është i detyrueshëm për zbatim, duke dhënë një vendim në kundërshtim me të.

9. *Subjekti i interesuar, DPD-ja*, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

9.1 Kërkuësja nuk ka *shteruar mjetet juridike efektive* në dispozicion, pasi në vendimin e gjykatës së apelit ajo nuk ka paraqitur rekurs për pjesën e papranuar të padisë, për rrjedhojë nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës me pretendimin për mosrespektimin e afateve, sipas nenit 143 të Kodit të Punës.

9.2 Kërkuësja nuk legjitimohet *ratione materiae* në këto drejtime:

9.2.1 Për sa i përket pretendimit për cenimin e *së drejtës së aksesit*, pasi shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit nga Gjykata e Lartë është një e drejtë që buron nga neni 61, pika 1, i ligjit nr. 49/2012. Referuar vendimit unifikues nr. 19/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, zgjidhja e kontratës është shprehje e vullnetit të njëres palë dhe e detyrueshme për njoftim palës tjetër. Në kushtet kur gjykatat e faktit kanë pranuar se subjektet e interesuara kanë respektuar afatin e njoftimit, duke e dëmshtëpërblyer kërkuësen me 3 paga mujore, atëherë kontrata e punës konsiderohet e zgjidhur normalisht. Respektimi i neneve 141, 143 dhe 145 të Kodit të Punës sjell përfundimin në mënyrë të natyrshme të kontratës së punës.

9.2.2 Pretendimet e kërkuësës për cenimin e *parimit të barazisë përpara ligjit* dhe *parimit të kontradiktoritetit* nuk janë ngritur në nivel kushtetues,



pasi ato lidhen me përmbajtjen e normave ligjore që kanë përcaktuar juridiksionin gjyqësor për shqyrtimin e këtyre lloj çështjeve, si dhe rregullat procedurale të gjykimit në Gjykatën e Lartë. Për më tepër, nën dritën e parimit kushtetues të sanksionuar në nenin 18 të Kushtetues, Gjykata ka pohuar se parimi i barazisë përpara ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme.

9.2.3 Pretendimet e kërkuësës për cenimin e *parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj* janë të pabazuara, pasi kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve e rrethanave të çështjes dhe interpretimin e ligjit, çka i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

9.2.4 Pretendimi për cenimin e *parimit të sigurisë juridike* është i pabazuar, pasi ndonëse kanë kaluar 7 vjet që kur vendimi është ekzekutuar vullnetarisht nga DPD-ja, kjo e fundit ka ushtruar rekurs, i cili i është njoftuar kërkuësës. Në këto kushte, ajo ka qenë në dijeni se procesi vazhdon.

9.2.5 Pretendimet për mënyrën e marrjes së provave dhe zbatimit të ligjit procedural e material, si dhe mosrespektimi i vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë lidhen me vlerësimin e fakteve dhe të rrethanave të çështjes dhe, si të tilla, nuk mund të merren në shqyrtim.

9.3 Për sa i takon *themelit të kërkesës*, pretendimet e kërkuësës për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* janë të pabazuara, pasi vendimi i Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë përmban të dhënat e palëve, vendimmarrjet e gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit, pretendimet e palëve, ligjin e zbatueshëm, si dhe pjesën arsyetuese ku gjykata mbështet qëndrimin e saj të shprehur në dispozitiv. Vendimi nuk është kontradiktor, alogjik, i pamjaftueshëm ose me kundërthënie, ose në mungesë të elementeve formale të parashikuara nga standardet e vendosura nga jurisprudenca kushtetuese.

10. Subjekti i interesuar, MF-ja, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar si vijon:

10.1 Kërkuësja *nuk ka shënuar mjetet juridike efektive në dispozicion*, pasi në asnjë nga ankimet kundër vendimeve të gjykatave nuk ka pretenduar cenimin e ndonjë norme procedurale dhe kjo vlen edhe në lidhje me pretendimin për cenimin e *parimit të sigurisë juridike*, pasi rasti objekt shqyrtimi nuk lidhet me një normë e cila cenon këtë parim.

10.2 Pretendimet e kërkuësës për cenimin e *së drejtës së aksesit* janë të pabazuara, pasi shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi nga Gjykata e Lartë nuk cenon të drejtat e saj. Kjo gjykatë shqyrton ligjshmërinë e vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta.

10.3 Pretendimi për cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi Gjykata e Lartë ka arsyetuar qartë në vendimin e saj, duke argumentuar situatën objekt konflikti gjyqësor. Kërkuësja ka qenë e punësuar pranë DPD-së me kontratë pune me afat të pacaktuar deri në momentin e njoftimit për ristrukturimin dhe shkurtimin e vendit të saj të punës. Proceset e ndryshme dhe dinamike në lidhje me fushën e veprimtarisë që ushtrojnë organet publike diktojnë, herëpashere nevojën e ristrukturimit të tyre, çka e bën ristrukturimin shkak të ligjshëm. Në rastin e kërkuësës, shkak i ndërprerjes së marrëdhënieve të saj të punës ka qenë shkurtimi i vendit të punës. Zgjidhja e kontratës së punës për këtë shkak nuk konsiderohet e pajustificuar. Kërkuësja është dëmshpërblyer me 3 paga mujore për afatin e njoftimit, ndërsa kthimi i saj në vendin e punës bie ndesh me vendimet unifikuese nr. 31, datë 14.4.2003, nr. 8 dhe nr. 10, datë 12.9.2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Vendimet unifikuese e lidhin dëmshpërblimin me pushimin e padrejtë, ndërkohë që kërkuësja është larguar për arsye ristrukturimi. Sipas qëndrimeve të vazhdueshme të Gjykatës së Lartë, respektimi i neneve 141, 143, 144 dhe 145 të Kodit të Punës, si rregull, sjell përfundimin në mënyrë të natyrshme të marrëdhënieve të punës dhe respektimin e të gjitha të drejtave të punëmarrësit, pasi ligji lë në vullnetin e njëanshëm të njëjës palë zgjidhjen e tyre, duke respektuar afatet e caktuara.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuësës

11. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë



themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

12. Kërkuesja legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, ndaj ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

13. Një kriter tjetër është *shterimi i mjeteve juridike efektive*, i parashikuar nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000, që kërkon shfrytëzimin në rrugë normale të mjeteve juridike efektive, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se shterimi i mjeteve juridike efektive përbën parakusht që duhet përmbyllur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur në formë dhe substancë të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 31, datë 29.5.2023; nr. 15, datë 11.3.2021; nr. 38, datë 25.4.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar, ndër të tjera, edhe cenimin e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, pasi Gjykata e Lartë nuk ka respektuar afatin e gjykimit të çështjes. Ky pretendim është ngritur për herë të parë në ankimin kushtetues individual, pa u shfrytëzuar mjetet juridike të parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së, që i garantojnë kërkueses mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në këto rrethana, Gjykata vlerëson se në lidhje me të kërkuesja nuk i ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, ndaj ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim.

15. Po kështu, subjekti i interesuar, DPD-ja, ka pretenduar se kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, pasi, pas vendimit të gjykatës së apelit, ajo nuk ka paraqitur rekurs për pjesën e papranuar të padisë, për rrjedhojë nuk legjitimohet t’i drejtohet Gjykatës me pretendimin

për mosrespektimin e afateve, sipas nenit 143 të Kodit të Punës.

16. Edhe sipas subjektit tjetër të interesuar, MF-së, kërkuesja nuk ka shteruar mjetet juridike efektive përpara se t’i drejtohet Gjykatës, pasi në asnjë nga ankimet kundër vendimeve të gjykatave nuk ka pretenduar cenimin e ndonjë norme procedurale dhe kjo vlen edhe për pretendimin për cenimin e parimit të sigurisë juridike.

17. Gjykata vëren se, ndonëse rekursi në Gjykatën e Lartë është ushtruar nga DPD-ja dhe MF-ja, kërkuesja ka paraqitur kundërrkurs, duke kërkuar lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit dhe duke parashtruar në të edhe pretendimet e saj në lidhje me shkaqet e rekurseve të paraqitura nga subjektet e interesuara. Gjithashtu, pretendimet e saj lidhen me vendimin e Gjykatës së Lartë, prandaj, në këto kushte, Gjykata i vlerëson të pabazuara pretendimet e subjekteve të interesuara, pasi kërkuesja nuk ka më mjete të tjera ankimi ndaj vendimit të kundërshtuar, për rrjedhojë e ka përmbyllur kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

18. Për sa i takon legjitimitet *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, parashikon afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në rastin konkret, vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 12.9.2023, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë, më datë 28.12.2023, për rrjedhojë vlerëson se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor.

19. Në drejtim të legjitimitet *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesja ka pretenduar se vendimi i Gjykatës së Lartë i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të së drejtës së aksesit dhe njoftimit, parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj, parimit të sigurisë juridike në drejtim të gjësë së gjykuar (*res judicata*), parimit të barazisë përpara ligjit dhe standardit të arsyetimit të vendimit, të cilat hyjnë në juridiksionin e Gjykatës.

20. Në lidhje me cenimin e së drejtës së aksesit dhe së drejtës së njoftimit, kërkuesja ka pretenduar se Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, pasi ka publikuar vendimin e tij në të njëjtën ditë në të cilën është gjykuar çështja. Subjekti i



interesuar, DPD-ja, ka prapësuar se shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi nga Gjykata e Lartë është një e drejtë që buron nga neni 61, pika 1, i ligjit nr. 49/2012, ndërsa sipas subjektit tjetër të interesuar, MF-së, shqyrtimi i çështjes në dhomë këshillimi nga Gjykata e Lartë nuk cenon të drejtat e kërkuases, pasi kjo gjykatë shqyrton ligjshmërinë e vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta.

21. Gjykata vëren se pretendimin për cenimin e së drejtës së aksesit dhe për t'u njoftuar kërkuësja e lidh me faktin e informimit në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë të vendimmarrjes së Kolegjit Administrativ. Nisur nga argumentet e paraqitura nga kërkuësja, Gjykata vlerëson se ajo nuk ka arritur të përcaktojë se si është cenuar në të drejtën e aksesit dhe për t'u njoftuar si rrjedhojë e publikimit të këtij njoftimi. Nga ana tjetër, për sa i përket shqyrtimit të çështjes nga Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi, Gjykata vë në dukje se neni 61, pika 1, i ligjit nr. 49/2012 parashikon se gjykimi i rekursit në Kolegjin Administrativ, si rregull, bëhet në dhomë këshillimi. Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuases për cenimin e së drejtës së aksesit dhe së drejtës për t'u njoftuar nuk janë argumentuar nga pikëpamja kushtetuese dhe nuk do të merren në shqyrtim.

22. Kërkuësja ka pretenduar cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka tejkaluar kufijtë e shqyrtimit të rekursit të përcaktuara në nenin 58, shkronja "a", të ligjit nr. 49/2012, sepse nuk e ka shqyrtuar çështjen mbi bazën e shkaqeve të rekursit, por është investuar pa të drejtë tek afati i njoftimit dhe te shkaku i ndërprerjes së marrëdhënies së punës, çka nuk referohet në rekursin e DPD-së. Subjekti i interesuar, DPD-ja, ka prapësuar se pretendimet e kërkuases janë të pabazuara, pasi kanë të bëjnë me vlerësimin e fakteve e të rrethanave të çështjes dhe interpretimin e ligjit, çka i përket juridiksionit të gjykatave të zakonshme.

23. Gjykata konstaton se si në rekursin e DPD-së, ashtu edhe në atë të MF-së, palët kanë prapësuar lidhur me afatin dhe shkaqet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, duke arsyetuar se zgjidhja e kontratës së punës ka ardhur për shkak të ristrukturimit. Këtyre shkaqeve Gjykata e Lartë u ka dhënë përgjigje, duke vepruar në këtë mënyrë brenda rolit dhe funksionit të saj kushtetues për interpretimin e ligjit, prandaj pretendimi i kërkuases

për cenimin e *së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* nuk mund të merret në shqyrtim.

24. Për sa i takon pretendimit të kërkuases se Gjykata e Lartë ka vepruar në *cenim të parimit të sigurisë juridike*, pasi ka marrë në shqyrtim dhe ka ndryshuar një vendim i cili kishte mbi 7 vjet që ishte ekzekutuar vullnetarisht, subjekti i interesuar, DPD-ja, ka prapësuar se pavarësisht kohës së gjatë që ka kaluar për shqyrtimin e çështjes, rekursi është ushtruar në afat dhe i është njoftuar kërkuases. Në këto kushte, kjo e fundit ka qenë në dijeni se procesi ishte ende në gjykim.

25. Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit, në pjesën që ka disponuar për detyrimin e palës së paditur për shpërblimin e kërkuases me 12 paga mujore, është i formës së prerë në kuptim të vënies në ekzekutim të tij. Pavarësisht këtij fakti, për sa i përket zgjidhjes në themel të mosmarrëveshjes mes palëve, ai nuk përbën një vendim përfundimtar me fuqinë e gjësë së gjykuar, për sa kohë që palët kanë përdorur mjetet e zakonshme të ankimit (*palët e paditura kanë paraqitur rekurs*). Në këtë pikë, Gjykata rithekson se siguria juridike nënkupton se kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Një vendim përfundimtar i formës së prerë është gjë e gjykuar kur zgjidh mosmarrëveshjen midis palëve në mënyrë përfundimtare (*shih vendimet nr. 55, datë 7.11.2023; nr. 10, datë 13.2.2017; nr. 12, datë 17.3.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata çmon se argumenti i parashtruar nga kërkuësja nuk mund të shërbejë si argument kushtetues në funksion të pretendimit për cenimin e parimit të sigurisë juridike, ndaj ai nuk do të merret në shqyrtim.

26. Gjithashtu, kërkuësja ka pretenduar edhe se Gjykata e Lartë nuk ka realizuar kalimin procedural nga MF-ja në MFE, bazuar në nenin 199 të KPC-së. Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka pohuar se moskrijimi i drejtë i ndërgjyqësisë cenon të drejtën për proces të rregullt ligjor në drejtëm të parimit të kontradiktoritetit në gjykim dhe barazisë së armëve. Megjithatë, pretendimi për mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë duhet analizuar në aspektin e lidhjes së drejtpërdrejtë që ka ekzistenca e shkeljes ligjore me vetë kërkuësin, si dhe të ndikimit që kjo shkelje mund të ketë sjellë mbi ecurinë e procesit gjyqësor (*shih vendimet nr. 26, datë 9.4.2024; nr. 34, datë 29.5.2015; nr. 13, datë 18.5.2006 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se



pretendimi i kërkuësës për mosformimin e drejtë të ndërgjyqësisë, nuk është argumentuar nga pikëpamja kushtetuese, në drejtim të evidentimit të ndonjë të drejte kushtetuese të cenuar për këtë shkak ose të pasojave që kjo ka sjellë në procesin në tërësi. Gjykata mban në konsideratë gjithashtu se në thelb bëhet fjalë për të njëjtin person juridik – Ministrinë e Financave e cila ka në varësi të saj DPD-në, ndaj në këtë kuptim ndërgjyqësia rezulton e formuar drejt.

27. Sipas kërkuësës, Gjykata e Lartë ka cenuar edhe *parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*, pasi nuk ka trajtuar me hollësi argumentet e parashtruara prej saj në kundërrekurs. Subjekti i interesuar, DPD-ja, ka prapësuar se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues, pasi ka të bëjë me përmbajtjen e normave ligjore që kanë përcaktuar juridiksionin gjyqësor për shqyrtimin e këtyre lloj çështjeve, si dhe rregullat procedurale të Gjykatës së Lartë. Ndërkohë, për të njëjtin argument, kërkuësja pretendon edhe cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit*. Gjithashtu, sipas saj, ky standard nuk është respektuar, sepse Gjykata e Lartë nuk i ka marrë në shqyrtim dhe nuk i ka vlerësuar shkaqet e rekurseve të paraqitura nga subjektet e interesuara, sipas përcaktimeve në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012.

28. Gjykata evidenton se mbi bazën e shkaqeve të ngritura në rekursin e DPD-së dhe MF-së, Gjykata e Lartë i ka marrë ato në shqyrtim, duke arsyetuar se, në thelb, qëndrimi i mbajtur nga Gjykata Administrative e Apelit nuk përputhet me parashikimet e ligjit material (*shih paragrafin 17 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Ndërkohë, fakti se kërkuësja ka paraqitur kundërrekurs pasqyrohet në vendimin e Gjykatës së Lartë (*shih paragrafin 14 të vendimit të Gjykatës së Lartë*), ndërsa pretendimet e ngritura në kundërrekurs kanë marrë përgjigje në analizën që kjo gjykatë u ka bërë vendimmarrjeve të gjykatave më të ulëta. Gjykata vë në dukje se detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve ndërgjyqëse, por ai varet nga natyra e vendimit në fjalë. Kur në rekurs janë ngritur pretendime të natyrës kushtetuese, Gjykata e Lartë, bazuar në natyrën e gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, si dhe në parimin e subsidiaritetit që udhëheq raportet ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, duhet të

investohet në ekzaminimin e tyre dhe të mbajë një qëndrim të shprehur lidhur me to (*shih vendimet nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 11, datë 16.4.2018; nr. 45, datë 3.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë këndvështrim, Gjykata çmon se pretendimet e kërkuësës për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe standardit të arsyetimit të vendimit, për shkak të mosdhënies përgjigje argumenteve të parashtruara në kundërrekurs, si dhe të shkaqeve të ngritura në rekurs, janë haptazi të pabazuara.

29. Kërkuësja ka pretenduar edhe *cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit*, pasi vendimi objekt kundërshtimi nuk ka marrë parasysh jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë, si dhe është kontradiktor me vendimmarrjen e saj në raste të ngjashme. Për të njëjtin argument kërkuësja pretendon edhe cenimin e *standardit të arsyetimit të vendimit*.

30. Gjykata në jurisprudencën e saj, kur kërkuësit kanë pretenduar cenimin e parimit të barazisë përpara ligjit në lidhje me mënyrën se si gjykatat kanë vendosur në raste të ngjashme, ka theksuar se vlerësimi kushtetues i mënyrës së zgjidhjes së çështjeve të ngjashme nga gjykatat e zakonshme bëhet rast pas rasti, duke iu referuar edhe rastit konkret. Fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, harmonizuar edhe me rrethanat, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih vendimet nr. 19, datë 21.3.2024; nr. 17, datë 23.3.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjithashtu, Gjykata rastet e ekzistencës së disa vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, ku ajo është shprehur në mënyrë të ndryshme për interpretimin e ligjit, i ka trajtuar edhe në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike duke u shprehur se ky fakt nuk mund të sjellë pritishtëri të ligjshme të kërkuësit për zbatimin e ligjit, në kushtet kur nuk është kryer një interpretim unifikues ose njëses në lidhje me të (*shih vendimin nr. 4, datë 31.1.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

32. Megjithatë, Gjykata vëren se pretendimi në rastin në shqyrtim nuk varet nga konteksti individual i çështjes ose nga rrethanat, faktorët e provat



gjyqësore të saj, por lidhet ekskluzivisht me mënyrën se si Gjykata e Lartë ka interpretuar ligjin, konkretisht nenet 141 dhe 143 të Kodit të Punës në kuptim të respektimit të afatit të njoftimit në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës me kohëzgjatje të pacaktuar, kur punëdhënësi paguan paraprakisht pagën korresponduese të këtij afati. Në lidhje me këtë çështje ligjore Gjykata e Lartë është shprehur në vendimin unifikues nr. 19/2007. Gjithashtu, së fundmi, Gjykata e Lartë, bazuar në rolin e saj si gjykatë ligji, sipas nenit 141 të Kushtetutës, për të njëjtën çështje ligjore ka evidentuar praktika/qëndrime të ndryshme në vendimet e saj, por edhe në interpretimet e gjykatave më të ulëta. Për këtë arsye, me vendimin e datës 26.7.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, pasi ka argumentuar nevojën për njësimin e praktikës gjyqësore në këtë drejtim, ka vendosur kalimin për njësim të çështjes. Ky vendim është publikuar në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë.

33. Nisur nga kjo situatë, Gjykata thekson se zbatimi në mënyrë uniforme i ligjit, garantimin e të cilit, në instancë të fundit, Kushtetuta në nenin 141 ia ka ngarkuar në mënyrë të shprehur Gjykatës së Lartë, është një element thelbësor i parimit të barazisë përpara ligjit. Ky i fundit së bashku me parimin e sigurisë juridike ndërlidhen midis tyre me qëllim garantimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë. Kjo do të thotë se individët kanë pritshmëri të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe mund të referohen në vendime gjyqësore të mëparshme për raste të ngjashme, në mënyrë që të parashikojnë efektet juridike të veprimeve ose mosveprimeve të tyre. Prandaj, duke qenë se konteksti i rrethanave konkrete të rastit në shqyrtim lidhet ekskluzivisht me mënyrën e interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë, Gjykata çmon ta analizojë pretendimin e kërkuës në këndvështrim të *parimit të sigurisë juridike* të lidhur me *parimin e barazisë përpara ligjit*, me qëllim që t'i japë përgjigje pyetjes nëse vendimi unifikues nr. 19/2007 dhe praktika të tjera të ndryshme të Gjykatës së Lartë përbëjnë bazë për të krijuar pritshmëri të ligjshme për kërkuësen në drejtim të parashikueshmërisë, njëtrajtshmërisë, qëndrueshmërisë së zbatimit të ligjit dhe trajtimit të saj në mënyrë të barabartë me individët e tjerë.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit

34. Kërkuësja ka pretenduar se Kolegji Administrativ nuk ka marrë parasysh jurisprudencën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Ai ka arritur në konkluzione diametralisht të kundërta, referuar edhe vetë jurisprudencës së tij, me të njëjtën trup gjykues. Në raste të ngjashme, Gjykata e Lartë nuk ka marrë parasysh rekursin e paraqitura nga administrata publike.

35. Subjekti i interesuar, DPD-ja, ka prapësuar se sipas jurisprudencës kushtetuese e drejta për një proces të rregullt ligjor nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëjta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme.

36. Gjykata ka vlerësuar se siguria juridike, mbrojtja e të drejtave të fituara, si dhe e pritshmërive të ligjshme, si standarde kushtetuese të trajtuara vazhdimisht nga jurisprudenca kushtetuese, përbëjnë elemente të parimit të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenin 4 të Kushtetutës. Parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 17 datë 23.3.2023; nr. 11, datë 16.4.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Po kështu, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se neni 18 i Kushtetutës parashikon se të gjithë duhet të jenë të barabartë përpara ligjit. Ky parim synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë, por edhe në të drejtat e tjera ligjore (*shih vendimin nr. 27, datë 29.6.2021 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo do të thotë se barazia në të drejta, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në çështje të ngjashme nga gjykatat e zakonshme. Lidhur me këtë, Gjykata ka theksuar se Kushtetuta i ka dhënë Gjykatës së Lartë autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t'u përmbahen. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera ose vetë kolegjet e asaj gjykate (*shih vendimet nr. 14 datë 21.3.2023; nr. 47, datë 3.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Për sa u përket vendimeve kontradiktore midis gjykatave të të njëjtut nivel, veçanërisht atyre të Gjykatës së Lartë, Gjykata Evropiane për të Drejtat



e Njeriut është shprehur se vazhdimësia e vendimeve gjyqësore kontradiktore mund të krijojë një gjendje pasigurie juridike që mund të ulë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, ndërkohë që një besim i tillë është padyshim një nga elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Megjithatë, thjesht fakti që ekziston një konflikt në praktikën e gjykatave nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të konstatuar shkelje të parimit të sigurisë juridike. Kur evidentohen zgjidhje të ndryshme të çështjeve gjyqësore të njëjta, në parim, ato duhet të ndiqen nga unifikimi dhe harmonizimi i praktikës, nëpërmjet mekanizmave të ngritur për këtë qëllim, kryesisht nga Gjykata e Lartë (*shih Nejdet Şahin dhe Perihan Şahin kundër Turqisë, aplikimi nr. 13279/05, datë 20.10.2011, §§§ 57, 61, 80*).

39. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se parimi i sigurisë juridike dhe ai i barazisë përpara ligjit, si elemente të shtetit të së drejtës, përbëjnë bazën e një shoqërie që respekton dhe zbaton ligjin në mënyrë të barabartë për të gjithë, si dhe siguron një proces të drejtë dhe të paanshëm, duke i detyruar gjykatat të jenë transparente në veprimtarinë e tyre. Kjo do të thotë se ekziston një lidhje e qenësishme midis konsideratave në lidhje me uniformitetin e praktikës gjyqësore dhe parimin e sigurisë juridike. Praktika gjyqësore që përcakton rregulla të qarta, të qëndrueshme dhe të besueshme, që mbështeten në vendimet e mëparshme të marra në raste të ngjashme, siguron uniformitetin e qëndrimeve gjyqësore. Ndërsa barazia në të drejtë, mes të tjerash, përcakton edhe detyrimin për vendimmarrje të njëjtë dhe të qëndrueshme në lidhje me interpretimin e ligjit nga gjykatat e zakonshme.

40. Në këndvështrim të standardeve të mësipërme, Gjykata vë në dukje se në kushtet kur ka një vendim unifikues ose njëgues të Gjykatës së Lartë në drejtim të zbatimit të ligjit material ose procedural për një çështje të caktuar, ky fakt sjell pritshmëri për individin se ligji do të zbatohet dhe interpretohet në mënyrë uniforme, siç është njëguar me vendimin unifikues të Gjykatës së Lartë për të njëjtën çështje ligjore.

41. Në rastin në shqyrtim, sikurse u theksua më lart (*shih paragrafin 33*) Gjykata vëren se çështja ligjore, e cila është debatuar në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm në kuptim të vlerësimit të mënyrës së zgjidhjes së kontratës si të menjëhershme ose jo, lidhet me faktin nëse konsiderohet i respektuar nga punëdhënësi afati i

njoftimit në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës me afat të pacaktuar, në kuptim të neneve 141 dhe 143 të Kodit të Punës, duke pasur parasysh faktin se kërkesja është paguar paraprakisht nga punëdhënësi për pagën korresponduese të këtij afati.

42. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka arsyetuar se përderisa kërkesja është paguar për afatin e njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës, ky afat në kuptim të neneve 141 dhe 143 të Kodit të Punës konsiderohet i respektuar nga ana e punëdhënësit. Në këtë mënyrë, sipas gjykatës së shkallës së parë, ndërprerja e marrëdhënieve të punës nuk përbënte zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, referuar nenit 155 të Kodit të Punës (*shih faqen 8 të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë*).

43. Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se kontrata e punës është zgjidhur në mënyrë të menjëhershme dhe pa shkaqe të justifikuara. Sipas saj, referuar edhe interpretimit unifikues të vendimit nr. 19, datë 15.11.2007 të Gjykatës së Lartë, neni 141 pika 1, i Kodit të Punës normon se për zgjidhjen e kontratës me afat të pacaktuar palët duhet të respektojnë afatin e njoftimit. Po kështu, kjo dispozitë përcakton se kontrata me afat të pacaktuar përfundon kur zgjidhet nga njëra palë dhe ka përfunduar afati i njoftimit. Pra, ky nen, shprehet gjykata e apelit, përcakton në parim mënyrën e zgjidhjes së kontratës, duke respektuar afate taksative për njoftimin. Po sipas gjykatës së apelit, gjatë afatit të njoftimit kontrata e punës është në fuqi me gjithë faktin që njëra palë ka bërë të ditur zgjidhjen e saj dhe ajo përfundon me përfundimin e afatit të njoftimit. Në referim të nenit 143, pika 4, të Kodit të Punës, zgjidhja e kontratës pa respektuar afatin e njoftimit trajtohet si zgjidhje e kontratës me efekte të menjëhershme. Po sipas asaj gjykate, bazuar në nenin 153 të Kodit të Punës, riorganizimi strukturor i palës së paditur dhe shkurtimi i funksionit organik nuk përbëjnë shkaqe të justifikuara për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës nga punëdhënësi. Ndaj, bazuar në nenin 155 të Kodit të Punës, paditësja punëmarrëse gëzon të drejtën e dëmshpërblimit për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës (*shih faqet 16–19 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

44. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në referim të vendimit unifikues nr. 19/2007 dhe nenit 141 të Kodit të Punës, ka vlerësuar se kontrata e



punës mund të zgjidhej në mënyrë të njëanshme, por duke u respektuar afatet e njoftimit të përcaktuara në nenin 143 të Kodit të Punës, me qëllim që palët të kenë mundësi të marrin masa për rregullimin e situatës së tyre personale. Mosrespektimi i afatit të njoftimit sjell zgjidhjen e kontratës me efekte të menjëhershme. Kolegji Administrativ ka vlerësuar se nëpërmjet dhënies së pagës së 3 muajve, pala e paditur ka respektuar detyrimin e saj për të njoftuar paditësen brenda afateve të parashikuara nga neni 143, pika 1, i Kodit të Punës dhe kontrata e punës konsiderohej e zgjidhur normalisht, në respektim të nenit 141 të këtij kodi. Po sipas Gjykatës së Lartë, respektimi i kërkesave të neneve 143, 144 dhe 145 të Kodit të Punës nga punëdhënësi, sjell përfundimin në mënyrë të natyrshme të kontratës së punës dhe respektimin e të gjitha të drejtave të paditëses. Zgjidhja e kontratës së punës në rastin e kërkuar nuk është as në kushtet e zgjidhjes së menjëhershme pa shkaqe të justifikuara referuar nenit 155 të Kodit të Punës dhe as në kushtet e zgjidhjes së kontratës për motive abuzive referuar nenit 146 të këtij kodi (*shih paragrafët 20, 21 dhe 23 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

45. Në përputhje me standardet kushtetuese dhe konventore të përmendura më lart Gjykata sjell në vëmendje se nuk është detyrë e saj të interpretojë ligjin dhe zbatojë atë në rastin konkret, pasi kjo i përket gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 28, datë 11.4.2024; nr. 19, datë 7.7.2022; nr. 32, datë 30.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, nisur nga fakti se devijimet nga praktikat gjyqësore apo vendimet njësuere mund të pasjellin cenim të sigurisë juridike si dhe të vënë në dyshim trajtimin e barbartë të individëve, Gjykata çmon të analizojë përmbajtjen e vendimit unifikues nr. 19/2007 në drejtim të pritshmërive të kërkuar për zgjidhje të çështjes së saj në përputhje me të.

46. Po kështu, Gjykata vëren se në vendimin unifikues nr. 19/2007 Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë kanë konkluduar se zgjidhja e kontratës është shprehje e vullnetit të njëres palë në mënyrë të njëanshme dhe e detyrueshme për njoftim palës tjetër, duke respektuar formën dhe afatet e caktuara për njoftim. Në atë vendim është pranuar se ligji parashikon dy mënyra për zgjidhjen e kontratës, atë *normale*, duke respektuar afatin dhe procedurën e përcaktuar shprehimisht në ligj dhe atë të *jashtëzakonshme*, me efekt të menjëhershëm, pa

respektuar afatet e njoftimit. Kontrata me kohëzgjatje të pacaktuar, shprehet gjykata, përfundon kur zgjidhet nga njëra palë, në fund të afatit të njoftimit, siç parashikohet në nenin 141 të Kodit të Punës. Kjo dispozitë, sipas saj, jep në parim mënyrën e zgjidhjes së kontratës dhe se ligji e lë në vullnetin e njëanshëm të palës që të zgjidhë kontratën, duke respektuar afatet takstive të njoftimit, të përcaktuara në nenin 143 të këtij Kodi. Për të pasur zgjidhje të kontratës, shprehet gjykata, duhet të plotësohen dy kushte dhe konkretisht: i) shprehja e vullnetit të njëres palë për zgjidhjen e kontratës; ii) respektimi i afatit të njoftimit, pikërisht afatit midis njoftimit të zgjidhjes dhe përfundimit të kontratës. Gjykata ka theksuar në vendim se ligji ka lënë në dorë të palëve zgjidhjen e kontratës vetëm me kushtin e respektimit të afatit të njoftimit, pra palët të njoftohen në një periudhë të caktuar (paralajmërimi) përpara zgjidhjes përfundimtare të saj, me qëllim që të kenë mundësi të marrin masa për rregullimin e situatës së tyre personale. Gjatë afatit të njoftimit, ka pohuar gjykata, kontrata e punës është në fuqi, me gjithë faktin që njëra palë ka bërë të ditur zgjidhjen e saj dhe ajo përfundon me përfundimin e afatit të njoftimit. Zgjidhja e kontratës pa respektuar afatin e njoftimit, sipas gjykatës, trajtohet si zgjidhje me efekt të menjëhershëm nga neni 143, pika 4, i Kodit të Punës, zgjidhje e cila gjen rregullim në nenet 153–156 të këtij kodi.

47. Po kështu, Gjykata konstaton se për shkak të interpretimit të ndryshëm të ligjit nga gjykatat, e njëjta çështje ligjore, ajo në lidhje me respektimin e afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës, është shtruar për njësim më datë 26.7.2023, pra përpara vendimmarrjes objekt shqyrtimi nga Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë. Për këtë arsye, Gjykata, në kuptim të parimit të sigurisë juridike dhe atij të barazisë së armëve, për të evidentuar qëndrimet e tjera të Gjykatës së Lartë në të cilat ajo ka arritur në një përfundim të ndryshëm nga ai në vendimin e kundërshtuar, nuk do të ndalet në analizën e mënyrës së zgjidhjes nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të rasteve të tjera të ngjashme me atë të kërkuar, të pretenduara nga kjo e fundit, përderisa Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj ka vënë në dukje ekzistencën e dy qëndrimeve të ndryshme nga kolegjet e vetë Gjykatës së Lartë, si dhe nga gjykatat më të ulëta. Ndërkohë, çka është e rëndësishme të theksohet konsiston në faktin se çështja ligjore e



shtruar për njësim është zgjidhur më datë 12.12.2023, duke arritur në përfundimet njëse se afati i njoftimit në rastin e zgjidhjes së kontratës së punës me kohëzgjatje të pacaktuar nga punëdhënësi nuk konsiderohet i respektuar në kuptim të neneve 141 dhe 143 të Kodit të Punës kur punëdhënësi i paguan punëmarrësit paraprakisht, në formë dëmshpërblimi, shumën përkatëse të pagave të këtij afati dhe se ky dëmshpërblim nuk zëvendëson dhe nuk shuan detyrimin ligjor të punëdhënësit për të vijuar marrëdhënien juridike të punës deri në fund të afatit të njoftimit.

48. Në analizë të sa më lart, Gjykata eidenton se interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë në vendimin objekt kundërshtimi, duke vendosur se nëpërmjet pagesës së 3 muajve pagë për efekt të afatit të njoftimit, pala e paditur ka respektuar detyrimin e saj për të njoftuar paditësen dhe kontrata e punës konsiderohet e zgjidhur normalisht, nuk është në të njëjtën linjë me qëndrimin e vendimit unifikues nr. 19/2007. Ndonëse vendimi unifikues përcakton se kontrata e punës ligjorisht është në fuqi deri në përfundim të afatit të njoftimit për zgjidhjen e saj, Gjykata e Lartë nuk i është përmbajtur këtij qëndrimi. Gjithashtu, Kolegji Administrativ e ka marrë atë në shqyrtim dhe ka dhënë vendim për të, ndonëse kjo çështje ligjore ishte shtruar për njësim pak kohë përpara vendimit të kundërshtuar nga Gjykata e Lartë. Në këtë aspekt, Gjykata thekson se nga pikëpamja kushtetuese respektimi i afatit të njoftimit dhe zgjidhja e kontratës vetëm në përfundim të këtij afati merr rëndësi për individin, pasi në thelb lidhet si me të drejtën kushtetuese për punë, të garantuar nga neni 49 i Kushtetutës, ashtu edhe me atë për sigurime shoqërore, të garantuar nga neni 52 i Kushtetutës.

49. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë, duke mos analizuar çështjen konform vendimit unifikues të lartpërmendur, ka cenuar pritshmëritë e ligjshme të kërkuësës për zbatimin e ligjit në harmoni me praktikën gjyqësore të kësaj gjykate. Për më tepër, qëndrimi i Gjykatës së Lartë në vendimin unifikues të vitit 2007 është ripohuar prej saj edhe në vendimin njëse të vitit 2023. Prandaj, Gjykata vlerëson se interpretimi i dispozitave ligjore në rastin e kërkuësës, jo vetëm ka cenuar parimin e sigurisë juridike, por duke mos zbatuar ligjin në mënyrë të barabartë për të gjithë individët, për të cilët kontrata e punës është konsideruar e zgjidhur vetëm në përfundim të afatit

të njoftimit, ka cenuar edhe parimin e barazisë përpara ligjit.

50. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuësës për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me parimin e barazisë përpara ligjit janë të bazuara, sipas vlerësimit të mësipërm, ndaj kërkesa duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2023-3297(279), datë 12.9.2023, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën.
3. Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 11.6.2024.

Shpallur, më 11.7. 2024.

Kryetare: Holta Zaçaj (kundër)

Anëtarë: Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Fiona Papajorgji, Marjana Semini, Genti Ibrahim

Anëtarë kundër: Sonila Bejtja

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes me kërkuese Arlinda Mulgeci, me objekt “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3297(279), datë 20.9.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rigjykim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë*”, edhe pse bashkohemi me shumicën për sa i përket përfundimit të arritur për pranimin e kërkesës, ndajmë qëndrim të ndryshëm në lidhje me trajtimin kushtetues të saj, në drejtim të përcaktimit të së drejtës kushtetuese që gjen zbatim



në rastin konkret dhe përcaktimit të metodologjisë së kërkuar për arritjen në këtë konkluzion.

2. Shumica ka vlerësuar të marrë në analizë pretendimet e kërkuases në drejtim të *cenimit të parimit të barazisë përpara ligjit të lidhur me parimin e sigurisë juridike*, me qëllim që t'i japë përgjigje pyetjes, nëse vendimi unifikues nr. 19/2007 dhe praktika të tjera të ndryshme të Gjykatës së Lartë përbëjnë bazë për të krijuar pritshmëri të ligjshme për kërkuesen në drejtim të parashikueshmërisë, njëtrajtshmërisë, qëndrueshmërisë së zbatimit të ligjit dhe trajtimit të saj mënyrë të barabartë me individët e tjerë (*shih paragrafët 33 dhe 45 të vendimit*). Sipas saj, interpretimi i ligjit nga Gjykata e Lartë në vendimin objekt kundërshtimi, duke vendosur se nëpërmjet pagesës së 3 muajve pagë për efekt të afatit të njoftimit, pala e paditur ka respektuar detyrimin e saj për të njoftuar paditësen dhe kontrata e punës konsiderohet e zgjidhur normalisht, nuk është në të njëjtën linjë me qëndrimin e vendimit unifikues nr. 19/2007 (*shih paragrafin 48 të vendimit*). Po ashtu, interpretimi i dispozitave ligjore në rastin e kërkuases, jo vetëm ka cenuar parimin e sigurisë juridike, por duke mos zbatuar ligjin në mënyrë të barabartë për të gjithë individët për të cilët kontrata e punës është konsideruar e zgjidhur vetëm në përfundim të afatit të njoftimit, ka cenuar edhe parimin e barazisë përpara ligjit (*shih paragrafin 49 të vendimit*).

3. Duke pasur parasysh se Gjykata e ka pranuar tashmë se ekzistenca e një vendimi unifikues të Gjykatës së Lartë krijon pritshmëri të ligjshme për palët ndërgjyqëse, për aq sa vendimi unifikues është i zbatueshëm për çështjet e tyre (*shih vendimin nr. 4, datë 31.1.2024, paragrafët 34–35*), në ndryshim nga shumica, ne, gjyqtarët në paralel, vlerësojmë se kjo pritshmëri duhet analizuar rast pas rasti dhe jo detyrimisht kërkon shqyrtimin e kërkesës nga Gjykata në drejtim të parimit të barazisë përpara ligjit dhe cenimit të këtij parimi. Tipikisht, pretendimet për cenimin e barazisë përpara ligjit lindin në kontekstin e zbatimit të diferencuar të ligjit, për kuptimin e të cilit (të ligjit) nuk ka dyshime (dhe për pasojë as nevojë për unifikimi të interpretimit), ndërsa pritshmëritë e ligjshme që lindin për shkak të ekzistencës së një vendimi unifikues lidhen me interpretimin e ligjit nga Gjykata e Lartë dhe mënyra e vetme për Gjykatën për të kontrolluar nëse në rastin konkret ka pasur ose jo cenim të pritshmërive të ligjshme të kërkuases është përmes verifikimit të arsytimit të gjykatave të zakonshme (përfshi

Gjykatën e Lartë), të cilat kanë për detyrë të shpjegojnë nëse vendimi unifikues është apo nuk është i zbatueshëm në rastin konkret. Në një çështje ku Gjykatës i është kërkuar zgjidhja e konfliktit mes një vendimi unifikues dhe akteve të tjera ligjore, kjo Gjykatë ka theksuar se qëllimi i saj nuk është të vërë në diskutim vlerën që kanë vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë në rendin juridik dhe as detyrimin ligjor që kanë gjykatat më të ulëta që të marrin parasysh dhe zbatojnë në çështje analoge zgjidhjet e dhëna në këto vendime. Në rastin në shqyrtim mënyra si e ka paraqitur gjykata referuese këtë çështje del jashtë kuadrit të parimit të sigurisë juridike dhe atij të barazisë përpara ligjit (*shih vendimin nr. 6, datë 17.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

4. Në kontekstin e çështjes konkrete, pavarësisht mënyrës si janë ngritur nga kërkuësja pretendimet e saj, të cilat i referohen edhe moszbatimit të vendimit unifikues në raport me përcaktimet e dispozitave të Kodit të Punës (*shih paragrafët 8.4, 8.6 dhe 8.7 të vendimit*), vlerësojmë se çështja duhej të ishte shqyrtuar në aspekt të *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor në lidhje me interesat e ligjshëm dhe të drejtën për punë*.

5. Konkretisht, shumica duhej të analizonte sa vijon: (i) *së pari*, nëse Gjykata e Lartë ka arsyetuar për zbatueshmërinë e vendimit unifikues në çështjen objekt shqyrtimi. Ky standard kërkon që Gjykata e Lartë, si rregull, të arsyetojë nëse vendimi unifikues që është sjellë në vëmendje të saj nga palët ka ose jo lidhje mjaftueshëm me çështjen objekt shqyrtimi (ndonëse në disa raste arsyetimi mund të konsiderohet i mjaftueshëm edhe pse Gjykata e Lartë nuk e shpjegon drejtpërdrejt lidhjen midis vendimit unifikues dhe çështjes objekt shqyrtimi) (*shih vendimin nr. 59, datë 14.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*); (ii) *së dyti*, vetëm nëse në analizë të arsytimit të vendimit do të vlerësonte se zbatimi i ligjit, së bashku me interpretimin e dhënë nga vendimi unifikues, kanë qenë dukshëm arbitrare në këndvështrimin kushtetues me pasojë antikushtetuese për individin, mund të kontrollonte zbatimin e tyre në çështjen në shqyrtim, duke kryer funksion interpretues të ligjit, pavarësisht se, si rregull, nuk është detyrë dhe funksion i Gjykatës.

6. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se Gjykata e Lartë ka autoritetin të njësojë ose të ndryshojë praktikën gjyqësore për të siguruar uniformitetin e interpretimit të normave ligjore nga ana e gjyqtarëve të zakonshëm, përmes përcaktimit



të linjave të interpretimit të cilave gjyqtarët duhet t'u përmbahen. Përfundimet në të cilat arrin Gjykata e Lartë nuk vlejnë vetëm për rastin konkret të zgjidhur prej saj, por për të gjitha rastet e ngjashme për gjykatat e tjera ose vetë kolegjet e thjeshta të asaj gjykate (*shih vendimet nr. 33, datë 23.4.2024; nr. 14, datë 21.3.2023; nr. 47, datë 3.7.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në këndvështrim të kësaj jurisprudence theksojmë se vendimet unifikuese ose njësuere të Gjykatës së Lartë i shërbejnë njësimi të praktikës gjyqësore në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit në çështje konkrete dhe një veprimtari e tillë përfshihet brenda kompetencave kushtetuese të Gjykatës së Lartë, të parashikuara në nenin 141 të Kushtetutës. Kjo do të thotë se pretendimet në lidhje me kuptimin e ligjit ose kuptimin e vendimit unifikues, si dhe pretendimi se ligji dhe vendimi unifikues bien ndesh me njëri-tjetrin ose nuk janë zbatuar drejt nga gjykatat, kanë të bëjnë, në thelb, me zbatimin dhe interpretimin e ligjit dhe, referuar jurisprudence kushtetuese, trajtohen nga gjykata si çdo pretendim tjetër në këtë drejtim. Ashtu siç dhe Gjykata ka pranuar në jurisprudence e saj, ajo ndërhyr vetëm atëherë kur gjatë procesit gjyqësor ka pasur shkelje të të drejtave kushtetuese ose zbatimi i ligjit ka qenë eventualisht arbitrar, në kuptimin që të bjerë ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës (*shih vendimet nr. 59, datë 14.11.2023; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Në rastin e kërkuarës rezulton se gjykatat e zakonshme kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me vlerësimin e mënyrës së zgjidhjes së kontratës së punës me afat të pacaktuar dhe respektimin nga punëdhënësi të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kësaj kontrate, në kuptim të neneve 141 dhe 143 të Kodit të Punës. Kështu, sipas gjykatës së shkallës së parë, meqenëse kërkuarja ishte paguar për mosrespektimin e afatit të njoftimit, vjetërsinë në punë dhe lejen vjetore të pakryer, afati i njoftimit konsiderohet i respektuar nga ana e punëdhënësit. Ndërsa sipas gjykatës së apelit, gjatë afatit të njoftimit kontrata e punës është në fuqi, pavarësisht se njëra palë ka bërë të ditur zgjidhjen e saj dhe kontrata përfundon me përfundimin e afatit të njoftimit. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se nëpërmjet dhënies së pagës së 3 muajve, pala e paditur ka respektuar afatin e njoftimit të parashikuar nga neni 143, pika 1, i Kodit të Punës dhe kontrata e punës konsiderohet e zgjidhur

normalisht, në respektim të nenit 141 të këtij kodi (*shih paragrafin 20 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

9. Duke e analizuar çështjen në vështrim të standardeve të mësipërme (*shih paragrafin 7 të kësaj pakice*), rezulton se Gjykata e Lartë ka arsyetuar lidhur me vendimin unifikues nr. 19/2007 dhe, sipas saj, ky vendim (vendimi unifikues) ka konkluduar se kontrata përfundon me përfundimin e afatit të njoftimit (*shih paragrafin 44 të vendimit*). Në vlerësimin tonë, vendimi unifikues nr. 19/2007 nuk ka analizuar periudhën 3-mujore të njoftimit për qëllime të zgjidhjes së kontratës së punës me afat të pacaktuar dhe nuk ka përcaktuar shprehimisht se, ndonëse punëmarrësi përfiton pagën e afatit të njoftimit pa u respektuar afati i njoftimit, kontrata e punës është në fuqi deri në përfundimin e afatit të njoftimit, qëndrim ky i mbajtur në vendimin njësuere të Gjykatës së Lartë të datës 12.12.2023. Në këtë kuptim, vlerësojmë se kërkuarja nuk kishte pritshmëri nga vendimi unifikues nr. 19/2007, i cili në fakt ka deklaruar përmbajtjen e ligjit, duke u shprehur se kontrata përfundon me përfundimin e afatit të njoftimit. Po kështu kërkuarja nuk kishte pritshmëri as nga vendimi njësuere i vitit 2023, i cili, në interpretim të dispozitave të Kodit të Punës, ka vlerësuar se, edhe nëse punëmarrësi do të marrë pagën e 3 muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit, kontrata përfundon gjithsesi me përfundimin e afatit të njoftimit *de jure*. Pavarësisht se ky vendim njësuere i Gjykatës së Lartë kishte lidhje me çështjen e kërkuarës, ai ka dalë pas vendimit objekt kundërshtimi. Në këto kushte, çmujmë se në rastin e kërkuarës nuk ka cenim të parimit të sigurisë juridike, në vetvete, nga moszbatimi i vendimeve unifikuese dhe njësuere në fjalë.

10. Në vlerësimin tonë, Gjykata e Lartë ka cenuar *standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor të lidhur me interesat e ligjshëm dhe të drejtën për punë*, për sa i takon interpretimit të neneve 141, pika 1 dhe 143 të Kodit të Punës, të cilat, në rastin e kërkuarës, dukshëm nuk janë arsyetuar ashtu sikundër vetë dispozitat ligjore parashikojnë, qoftë në kuptimin literal, qoftë në atë qëllimor, pasi nëse kontrata e punës nuk do të konsiderohej e zgjidhur në përfundim të afatit të njoftimit, por 3 muaj para, mund të sillte pasoja antikushtetuese për punëmarrësin, si pala më e dobët në kontratë, për sa u përket garancive për përfundimin e një marrëdhënieje punësimi, si llogaritja e vjetërsisë në punë apo përfitimeve të natyrave të tjera, pasi në thelb lidhet si me të drejtën



kushtetuese për punë të parashikuar nga neni 49 i Kushtetutës, ashtu edhe me atë për sigurime shoqërore të parashikuar nga neni 52 i Kushtetutës.

11. Si përfundim, për të gjitha arsyet e mësipërme, vlerësojmë se kërkesa duhej pranuar, sipas këtij arsyetimi.

Anëtarë: Genti Ibrahimi, Elsa Toska

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes me kërkuese Arlinda Mulgeci, me objekt: *“Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2023-3297(279), datë 20.9.2023 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Dërgimi i çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë”*, ne, gjyqtaret në pakicë, duke qenë se nuk ndajmë të njëjtën mendim në lidhje me përfundimin e arritur nga shumica për shfuqizimin e vendimit gjyqësor të kundërshtuar dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, vlerësojmë të shprehemi me mendim pakice.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes rezulton se kërkueses i është njoftuar lirimi nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit pranë të cilit ajo ishte e punësuar. Duke mos qenë dakord me këtë vendim, kërkuësja u është drejtuar gjykatave të zakonshme me pretendime për dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës. Në analizë të vendimmarrjeve të gjykatave të faktit, rezulton se gjykata administrative e shkallës së parë dhe ajo e apelit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme në lidhje me vlerësimin e mënyrës së zgjidhjes së kontratës së punës me afat të pacaktuar dhe respektimin nga punëdhënësi të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kësaj kontrate, në kuptim të neneve 141 dhe 143 të Kodit të Punës (KP) dhe vendimit unifikues nr. 19/2007 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Kështu, sipas gjykatës së shkallës së parë, meqenëse kërkuësja ishte paguar për afatin e njoftimit (3 muaj), vjetërsinë në punë dhe lejen vjetore të pakryer, afati i njoftimit konsiderohej i respektuar nga ana e punëdhënësi. Ndërsa sipas gjykatës së apelit, gjatë afatit të njoftimit kontrata e punës është në fuqi, pavarësisht faktit që njëra palë ka bërë të ditur zgjidhjen e saj dhe ajo përfundon me mbarimin e afatit të njoftimit.

3. Gjykata e Lartë, e vënë në lëvizje nga palët e paditura në procesin gjyqësor, ka lënë në fuqi

vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se nëpërmjet dhënies së pagës së 3 muajve pala e paditur kishte respektuar afatin e njoftimit të parashikuar nga KP-ja dhe kontrata e punës konsiderohej e zgjidhur normalisht, në respektim të nenit 141 të këtij kodi. Po sipas asaj gjykate, ligji ka lënë në dorë të palëve zgjidhjen e kontratës vetëm me kushtin e respektimit të afatit të njoftimit, pra palët të njoftohen në një periudhë të caktuar (paralajmërimi) përpara zgjidhjes përfundimtare të kontratës, me qëllim që të kenë mundësi të marrin masa për rregullimin e situatës së tyre personale.

4. Në këto kushte, kërkuësja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, pretendime të cilat shumica ka vendosur t'i analizojë në drejtim të parimit të sigurisë juridike të lidhur me atë të barazisë përpara ligjit, duke vlerësuar mënyrën se si kanë arsyetuar dhe zbatuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm vendimin unifikues nr. 19/2007 në raport me përcaktimet e dispozitave të KP-së. Në lidhje me themelin e këtyre pretendimeve shumica ka vlerësuar se vendimi unifikues nr. 19/2017 ka sjellë pritshmëri për kërkuesen se ligji do të zbatohet dhe interpretohet në mënyrë uniforme në përputhje me atë vendim. Ajo ka arritur në përfundimin se interpretimi i Gjykatës së Lartë se pagesa e shpërblimit të 3 muajve pagë nënkupton përmbushjen e detyrimit për efekt të njoftimit nuk është në linjë me vendimin unifikues nr. 19/2007 dhe në këtë mënyrë kërkueses i janë cenuar pritshmëritë e ligjshme për zbatimin e ligjit në harmoni me praktikën gjyqësore (*shih paragrafët 40, 48 dhe 49 të vendimit*).

5. Në ndryshim nga shumica, ne gjyqtaret në pakicë, vlerësojmë, së pari, se pretendimet e kërkueses nuk duhet të ishin analizuar të lidhura me parimin e barazisë përpara ligjit, por në drejtim të parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit. Ashtu siç arsyetohet edhe shumica, fakti që gjykatat e zakonshme kanë vendosur ndryshe në një rast të ngjashëm, në vetvete nuk mund të justifikojë *apriori* pretendimet e individit, pasi mënyra e zgjidhjes së çështjes dhe e zbatimit të ligjit është e drejtë e çdo gjykate, për sa kohë çdo çështje konkrete është specifike dhe ka individualitetin e saj, e harmonizuar edhe me rrethana, faktorë, motive ose prova gjyqësore, të cilat nuk mund të jenë të njëjta (*shih paragrafin 30 të vendimit*). Megjithatë, sipas shumicës, zbatimi në mënyrë uniforme i ligjit, garantimin e të cilit, në instancë të fundit, Kushtetuta



në nenin 141 ia ka ngarkuar në mënyrë të shprehur Gjykatës së Lartë, është një element thelbësor i parimit të barazisë para ligjit. Kjo do të thotë se individët kanë pritshmëri të trajtohen në mënyrë të barabartë dhe mund të referohen në vendime gjyqësore të mëparshme për raste të ngjashme, në mënyrë që të parashikojnë efektet juridike të veprimeve ose mosveprimeve të tyre (*shih paragrafin 33 të vendimit*).

6. Së dyti, theksojmë se kjo qasje nuk pajtohet me atë të mbajtur më parë nga Gjykata në shqyrtimin e pretendimeve të kësaj natyre, që lidhen me mënyrën e zbatimit nga gjykatat e zakonshme të vendimeve unifikuese. Në një çështje të po këtij viti, gjyqtarët në shumicë, duke theksuar qëndrimin e jurisprudencës kushtetuese se zbatimi i ligjit (ku përfshihet edhe zbatimi i vendimeve unifikuese) është detyrë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për qëllime të procesit gjyqësor që ato zhvillojnë, e kanë shqyrtuar çështjen në këndvështrim të parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsyetimit dhe jo me parimin e barazisë përpara ligjit (*shih vendimin nr. 9, datë 27.2.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo sepse Gjykata nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt dhe për këtë arsye vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm nuk vihen në dyshim, përveç rasteve kur gjetjet e tyre mund të konsiderohen si arbitrare ose haptazi të paarsyeshme. Thënë ndryshe, Gjykata vepron në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e arsyeshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën të padrejtë (*shih vendimin nr. 30, datë 29.5.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Në respektim të kufijve juridiksionalë të kësaj Gjykate, pa vënë në diskutim vlerën e vendimeve unifikuese në rendin juridik dhe karakterin e detyrueshëm që ato kanë për gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por nisur nga prezumimi se i takon Gjykatës së Lartë të vlerësojë nëse në një çështje të caktuar gjen vend zbatimi i një vendimi unifikues, shumica duhej të ishte ndalur në rastin konkret vetëm në analizën nëse Gjykata e Lartë e ka zgjidhur çështjen dhe e ka arsyetuar vendimin, në kuptimin që i ka dhënë përmbajtjes së normës ligjore të zbatueshme, në kufijtë e interpretimit arbitrar. Pra, shumica duhej të vlerësonte në çështjen konkrete nëse arsyetimi i gjykatave ka qenë haptazi i paarsyeshëm, pra nëse përmban ndonjë gabim ligjor të dukshëm që e bën atë të parregullt nga pikëpamja

kushtetuese. Vetë shumica shprehet se konteksti i rrethanave konkrete të rastit në shqyrtim lidhet ekskluzivisht me mënyrën e interpretimit të ligjit nga Gjykata e Lartë (*shih paragrafin 33 të vendimit*), çka do të thotë se dhënia e një përgjigjeje për pyetjen e ngritur prej saj në rastin konkret ka të bëjë pikërisht me kufijtë e zbatimit të vendimit unifikues në drejtim të pritshmërive që sjell ai për palët, e lidhur kjo me mënyrën se si gjykatat e zakonshme arsyetojnë vendimet e tyre për zgjidhjen e çështjes konkrete.

8. Nga ana tjetër, edhe në rastet kur janë ngritur pretendime për praninë e dy vendimeve gjyqësore diametralisht të kundërta, Gjykata i ka vlerësuar ato nën dritën e së drejtës së aksesit dhe asaj të ankimit në kuptimin substancial, si edhe të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor (*shih vendimet nr. 86, datë 26.12.2017; nr. 73, datë 16.12.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Në vijim, edhe në lidhje me thelbin e këtij pretendimi, ne jemi të qëndrimit se ai është i pabazuar, ndaj Gjykata duhej të kishte vendosur rrëzimin e tij.

10. Sikurse ka pranuar Gjykata në jurisprudencën e saj, parimi i sigurisë juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe tek aktet që ato nxjerrin (*shih vendimet nr. 11, datë 21.4.2022; nr. 4, datë 21.2.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Për sa u përket vendimeve unifikuese të Gjykatës së Lartë, Kushtetuta i ka dhënë kësaj të fundit autoritetin të njësojë ose ndryshojë praktikën gjyqësore, pra të mbajë qëndrime në çështje të veçanta, me qëllim unifikimin e vendimmarrjes së gjykatave të zakonshme (*shih vendimet nr. 26, datë 22.5.2015; nr. 6, datë 17.2.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Shumica është shprehur në vendimin e saj, bazuar në jurisprudencën evropiane, se vazhdimësia e vendimeve gjyqësore kontradiktore mund të krijojë një gjendje pasigurie juridike që mund të ulë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, ndërkohë që një besim i tillë është padyshim një nga elementet thelbësore të shtetit të së drejtës. Thjesht fakti që ekziston një konflikt në praktikën e gjykatave nuk është i mjaftueshëm në vetvete për të konstatuar shkelje të parimit të sigurisë juridike. Kur evidentohen zgjidhje të ndryshme të çështjeve gjyqësore të njëjta, në parim, ato duhet të ndiqen nga unifikimi dhe harmonizimi i praktikës nëpërmjet mekanizmave të ngritura për këtë qëllim, kryesisht



nga Gjykata e Lartë (*shih paragrafin 38 të vendimit*). Megjithatë, pavarësisht këtij referimi shumica nuk ka arritur të sqarojë në vendimin e saj se pse në rastin konkret jemi para një situatë vazhdimësie në qëndrime kontradiktore të gjykatave të zakonshme në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e dispozitave të KP-së në zgjidhjen e çështjeve të kësaj natyre, aq sa kjo ka çuar në një gjendje të tillë pasigurie që ka ulur besimin e publikut duke nënkuptuar që pasiguria është e një natyre sistematike, që prek një kategori më të gjerë subjektsh se sa thjesht palët në konfliktin gjyqësor dhe, për këtë shkak, kërkon ndërhyrjen e Gjykatës për të garantuar respektimin e këtij parimi.

12. Thënë sa më sipër, thjesht divergjencat në jurisprudencën e një gjykate të zakonshme në zgjidhjen e konflikteve gjyqësore nuk janë të mjaftueshme *per se* për të gjetur shkelje të parimeve kushtetuese. Gjithashtu, ndonëse është shprehur se nuk është detyrë e saj të interpretojë ligjin, në thelb shumica duket sikur ka marrë pikërisht rolin e Gjykatës së Lartë, duke përcaktuar vetë përmbajtjen e vendimit unifikues dhe nëse ai është zbatuar drejt nga ajo gjykatë, ndërhyrje që mund të justifikohet vetëm nëse Gjykata do të kontrollonte vendimarrjen nën dritën e standardit të arsytimit të vendimit për interpretim arbitrar.

13. Edhe pse Gjykata është shprehur se kur evidentohen zgjidhje të ndryshme të çështjeve gjyqësore të njëjta, në parim, ato duhet të ndiqen nga unifikimi dhe harmonizimi i praktikës, nëpërmjet mekanizmave të ngritura për këtë qëllim, kryesisht nga Gjykata e Lartë (*shih vendimin nr. 4, datë 31.1.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), kjo nuk është e mjaftueshme në aspektin kushtetues për të vënë në dyshim mënyrën e zgjidhjes së një çështjeje të caktuar nga gjykatat e zakonshme. Pavarësisht lidhjes së qenësishme midis konsideratave në lidhje me uniformitetin e praktikës gjyqësore dhe parimit të sigurisë juridike, roli thelbësor në këtë drejtim i takon Gjykatës së Lartë, ndërsa juridiksioni kushtetues vihet në lëvizje vetëm në raste përjashtimore, siç kemi theksuar më sipër, pra kur interpretimi i ligjit për zgjidhjen e një çështjeje konkrete është i tillë që çon në arbitraritet, i cili mund të riparohet vetëm përmes ndërhyrjes së kësaj Gjykate.

14. Theksojmë se vendimet unifikuese ose njësuere të Gjykatës së Lartë i shërbejnë njësisht të praktikës gjyqësore në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit në çështje konkrete dhe një

veprimtari e tillë përfshihet brenda kompetencave kushtetuese të Gjykatës së Lartë, të parashikuara në nenin 141 të Kushtetutës. Në këtë kuptim, ritheksojmë se në çështjen konkrete në shqyrtim Gjykata duhet të kontrollonte nëse zbatimi i dispozitave të KP-së dhe vendimit unifikues nga Gjykata e Lartë shfaq problematika të tilla që e bëjnë vendimin e kësaj të fundit arbitrar në këndvështrimin kushtetues.

15. Në këtë drejtim ne vlerësojmë se vendimi unifikues i Gjykatës së Lartë nr. 19/2007 nuk ka përcaktuar shprehimisht se, ndonëse punëmarrësi përfiton pagën e afatit të njoftimit pa u respektuar afati i njoftimit, kontrata e punës është në fuqi deri në përfundimin e afatit të njoftimit, madje në të citohet edhe se respektimi i njoftimit ka si qëllim rregullimin e situatës personale, gjë e cila në gjykimin tonë krijon idenë se palët nuk mund të rrinë të lidhura gjatë këtij afati (*shih paragrafin 20 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Vendimi unifikues i ka dhënë përgjigje pyetjes nëse individ i ka të drejtën e përfitimit të dëmshpërblimit deri në një vit pagë nëse punëdhënësi zgjidh në mënyrë të njëanshme kontratën e punës me afat të pacaktuar, duke respektuar afatin e njoftimit. Në zbatim të këtij vendimi, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se kërkuesja nuk e përfitonte dëmshpërblimin, pasi zgjidhja e kontratës nuk është as në kushtet e zgjidhjes së menjëhershme pa shkaqe të arsyeshme dhe as në kushtet që ajo të jetë bërë për motive abuzive (*shih paragrafin 21 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

16. Për sa më lart, ne vlerësojmë se arsytimi i vendimit të Gjykatës së Lartë nuk paraqitet arbitrar për sa i përket zbatimit të ligjit, në kuptim të tillë që bie ndesh haptazi me konceptin e gjykimit të drejtë të përcaktuar në nenin 42 të Kushtetutës. Për më tepër, referimi i shumicës në një vendim njësuere, i cili ende nuk është zbardhur (*shih paragrafin 47 të vendimit*), nuk mund të përbëjë argument për të konstatuar se kërkueses i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor.

17. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ne, gjyqtaret në pakicë, çmojmë se pretendimi i kërkueses për cenimin e parimit të sigurisë juridike të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit është i pabazuar, prandaj Gjykata duhet të vendoste rrëzimin e kërkesës.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtare: Sonila Bejtja

**KËRKESË****Nr. 781/10, datë 15.7.2024****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën. Subjekti kërkues i këtij projekti është Operatori i Sistemit të Trasmetimit sh.a. Me anë të këtij publikimi, *kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim*, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasurinë e llojit “arë”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës bashkëlidhur. Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në

tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit pranë Operatorit të Sistemit të Trasmetimit sh.a., si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është **10,419.6 (dhjetë mijë e katërqind e nëntëmbëdhjetë pikë gjashtë) lekë.**

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE PARAPRAKE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, E TË CILËVE PREKEN NGA DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 822, DATË 19.12.2022, “PËR PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 KV BURREL–BULQIZË”

Nr.	PRONARI											SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Sipërfaqja totale	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja e shpronësimit (m ²)	Çmimi (lekë/m ²)	Vlera (lekë)	Adresa	Seksionet D dhe E të kartelës së pasurisë
	A	B	C	C	D	F	G	L	M	N		O
1	Bedri	Ramazan	Spahiu	2990	156/1/27	6100	arë	91.4	114	10,419.6	Fshati Plesh/Nj.A. Klos/Bashkia Klos	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA								91.40		10,419.60		

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 144 lekë

